

## Programi

**Këshillime me anëtarët e Rrjetit të Grave të Kosovës mbi themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi (KOMRA)**

### **Nevojat, pritjet e viktimave dhe drejtësia tranzicionale**

*(25.06.2009. Hotel „VICTORY“ - Prishtinë)*

- 10:00 – 10:15     **Hapja**  
**Shukrije Gashi**, Partners-Kosova, anëtare e Këshillit Koordinues e Koalicionit për Themelimin e KOMRA-s
- 10:15 – 11:45     **Nevojat, pritjet e viktimave dhe drejtësia tranzicionale**  
**Shukrije Gashi**,  
Përkrahja morale, materiale dhe ajo ligjore  
Drejtësia tranzicionale dhe zëri i viktimave  
  
Diskutime
- 11:45 – 12.00     **Përvojat e të tjerëve në përcaktimin e fakteve për të kaluarën**  
**Gazmir Raci**, Pro Peace Platform
- 12:00 – 12:15     Pauza
- 12.15-13.00     **Prezantimi i iniciativës për themelimin e KOMRA-s**
  - Qëllimi dhe rrjedha e këshillimeve
  - Përse KOMRA?**Nora Ahmetaj**, KOMRA  
**Suzana Kunac**, Koalicioni për KOMRA

13:00 – 14:00 **Shfaqja e filmit *Ballafaqimi me të vërtetën: Komisionet për të vërtetën dhe shoqëritë në tranzicion***

Diskutime  
**Nora Ahmetaj, REKOM**

14:00 -15.00 **Fjala përfundimtare: Komentet dhe propozimet**  
Zhvillimi dhe rekomandimet  
Moderatore: Shukrije Gashi

15.00 **Dreka**

Mbajtja e këshillimeve mbi KOMRA-n, mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze në Beograd



Ambassade van het  
**Koninkrijk der Nederlanden**

## **Lista e pjesëmarrësve:**

1	Atifete Demaj	Ne jemi pjesë e botës
2	Adelina Berisha	Rrjeti i grave të Kosovës
3	Klevis Vagari	Qendra për studime gjinore
4	Belgjyzare Muharremi	Dera e hapur
5	Bekim Blakaj	Fondi për të drejtën humanitare
6	Eli Krasniqi	Sociologe
7	Fahrije Elezi	Handikos
8	Flutura Xharra	Norma
9	Flurije Aliu	Nënat kryefamiljare
10	Gjylfidane Morina	Shoqata e amviseve të Kosovës
11	Nurije Ferati	Shoqata për mbrojtjen e viktimave dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore
12	Nerimane Gërguri	Familjare e viktimave
13	Sakibe Doli - Dobruna	Shtëpia e sigurtë
14	Sevdie Bunjaku	Kalabria
15	Suzana Berisha	Shpresa dhe shtëpia për fëmijë
16	Tahire Gashi	Zana
17	Valbona Çitaku	Shpresa dhe shtëpia për fëmijë
18	Veprorë Shehu	Medika
19	Lize Marku	Indira
20	Lale Grabanica	Elena Gjika
21	Lumnije Grajcevc	Aureola
22	Abdullah Ferizi	Forum Ziviler Friedensdienst, Priština
23	Sarah Maliqi	YIHR
24	Valdete Idrizi	Comunity Buildin Mitrovica, Mitrovica

## **Panelistët/Organizatorët**

Shukrije Gashi	Partners Kosova
Nora Ahmetaj	FDH
Gazmir Raci	Pro Peace Platform
Suzana Kunac	"BABE"
Mentor Rushti	Partners Kosova
Florent Hajrizi	Partners Kosova
Besarta Vasija	FDH, Kosovë
Selvie Rashani	Partners Kosova
Hilmije Ramavaja	Partners Kosova

## **Vëzhgues:**

Ana di Lellio	KIJAC
Justine Caccamo	Partners Kosova
Vasti Cedeno	Partners Kosova

Tilde Bergeren	Swedish Helsinki Comitee
Ivan Kuzminovic	Swedish Helsinki Comitee
Ani Sarkisan	FDH, Kosovo

Hapja e takimit:

**Shukrije Gashi:** Së pari, më duhet të them se më vjen keq që një numër i madh i grave, të cilat e kanë konfirmuar ardhjen, ende nuk kanë arritur që të jenë këtu dhe për këtë, siç duket, problem ka paraqitur moti i lig. Shpresoj se në çdo çast ato do të jenë të pranishme këtu. Ju falënderoj pra të gjithave që keni ardhur këtu dhe që keni gjet kohë, mundësi dhe interesim që të merrni pjesë në Këshillimin me anëtarët e Rrjetit të Grave të Kosovës mbi themelimin e Komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve të krimeve të luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi, dhe në lidhje me KOMRA-n. Siç kemi bashkëbiseduar herën e kaluar, domethënë në mbledhjen e fundit të Rrjetit përkitazi me këtë çështje, të gjitha anëtarët e Rrjetit – të organizatave të grave, janë deklaruar se kanë interesim të madh që të marrin pjesë në këshillime të tilla për arsye se këto këshillime janë të rëndësishme primare nga se kemi të bëjmë me atakimin e gjithë shoqërisë, në veçanti grupet të cilat kanë qenë më të goditura nga lufta, nga lufta në ish-Jugosllavi, lufta e fundit e vitit 1999 dhe tutje. Pra, ne jemi të gjithë të vetëdijshëm se në rrethana të tilla, ku shoqëritë, pas luftës, përballen me shumë probleme, një nga çështjet e ndjeshme të rënda për t'u zgjidhur mbeten gjithmonë statusi i viktimave për të gjitha kategoritë dhe kjo është një çështje e cila po ashtu e ka goditur rënd Kosovën dhe popullatën e Kosovës, të gjitha komunitetet dhe të them, fatmirësisht, shoqëria civile në Kosovë, në veçanti gratë gjithmonë me kujdesin të madh dhe respekt i kanë konsideruar të gjitha zhvillimet shoqërore duke i përfshirë edhe pasojat e luftës. Ne jemi të vetëdijshme se në këto ndërmarrje të mëdha shoqërore, një fat të rëndë dhe fatkeqësi e ka përjetuar gjatë gjithë këtyre zhvillimeve edhe gruaja në Kosovë në të gjitha përballjet. Prandaj, edhe "Partners Kosova" në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare, me SBM dhe të gjithë përkrasit tjerë të koalicionit rajonal për KOMRA kemi menduar se është e rrugës që të bashkëpunojmë në organizimin e këshillimeve të tilla, të cilat do të jenë shumë të rëndësishme dhe do t'i kontribuojnë zbardhjes së fatit të viktimave, themelimit të një Komisioni rajonal i cili ka për qëllim, në radhë të parë, që thjeshtë të mbledhë të dhëna mbi krimet e luftës në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë dhe në shtetin e Kosovës në mënyrë që fati i viktimave, të gjitha kategorive, duke përfshirë këtu me theks të veçantë gratë, vajzat, nuset – të gjitha ato që janë dhunuar dhe kanë përfunduar edhe me vdekje, familjet e tyre dhe të gjitha kategoritë tjera, veteranët e luftës, shoqatat e të zhdukurve, familjarët e tyre që tu bëhet e mundur që për ta të vihet drejtësia në vend duke siguruar shumëçka për ta. Duke filluar me emërtimin e tyre të plotë, me emra e mbiemra të viktimave dhe se ato të mos ngelin vetëm në numra, gjë e cila ka vazhduar të ngelet deri në ditët e sotme. Pastaj, duke siguruar përkrashjen sociale, shëndetësore dhe materiale për ta, duke siguruar një platformë me të cilën do të krijohet mundësi që të dëgjohet zëri i të gjithë të goditurve njësoj, duke siguruar legjislacionin i cili do t'i mbrojë ata në të gjitha aspektet e përmendura, varësisht nga mundësitë që këtyre viktimave në mënyrë të ligjshme tu sigurohet ndihma sociale, shëndetësore, materiale. Natyrisht në ndërmarrjet e tilla shoqëritë e pasluftës nuk mund të bëjnë një qasje të baraspeshuar mirëpo do të përpiqen që ta bëjnë maksimumin e mundshëm. Para se të vazhdomë pas këtij prezantimi tim, unë do të bëj edhe prezantimin e pjesëmarrësve këtu në panel dhe pastaj do të vazhdojmë me prezantimin edhe tuajin veç e veç, në mënyrë që

bashkëbisedimi të bëhet në formën e duhur. Pranë nesh, këtu në këtë panel janë përkrasit e Koalicionit KOMRA që po ashtu kanë bërë një punë të madhe dhe do t'i prezantoj me rend: zonjusha **Suzana Kunac**, e cila vjen nga Organizata, nga Kroacia – Babe dhe është përkrasit e Koalicionit KOMRA; në krahun tim tjetër është zonjusha **Nora Ahmetaj**, e cila po ashtu përfaqëson KOMRA-n dhe do ta ketë një prezantim bashkërisht me zonjushën Kunac, po ashtu në mesin e panelistëve është edhe zonjusha **Valdete Idrizi**, që përfaqëson Organizatën CBM dhe është po ashtu përfaqësuese e Këshillit koordinues për KOMRA-n dhe **Gazmir Raci**, i cili është panelit në këtë prezantim të sotëm të KOMRA-s. Kurse në vazhdimësi fjalën do të ua japin ju të tjerëve që fillimisht ta bëni prezantimin tuaj veç e veç. Po, si duket, atje qenka ulur Besarta dhe e lusim Besartën që prej saj të bëhet një prezantim më dinjitoz dhe të përfshihet secili këtu.

**Besarta Vasija:** Mirë dita! Ju përshëndes të gjithëve dhe faleminderit që keni gjetur kohë me ardhë. Unë jam Besarta Vasija, nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Jam koordinatore e Koalicionit për themelimin e Komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi.

**Sevdije Bunjaku:** Jam Sevdije Bunjaku, vi nga Organizata joqeveritare “Kalabria” në Prishtinë.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit!

**Belgjyzare Muharremi:** Unë, jam Belgjyzare Muharremi dhe jam drejtore ekzekutive në Qendrën e Gruas “Dera e hapur” këtu në Prishtinë e gjithashtu jam edhe kryetare e Bordit në “Rrjetin e grupit të grave të Kosovës”. Faleminderit!

**Shukrije Gashi:** Faleminderit, Belxhizare!

**Veprorë Shehu:** Jam Veprorë Shehu, përfaqësoj Organizatën “Medika Kosova” me seli në Gjakovë, e cila që nga përfundimi i luftës në Kosovë i përkrah femrat e traumatizuara nga lufta me shërbime psiko-sociale, gjinekologjike dhe juridike, me fokus të posaçëm femrat që kanë përjetuar dhunime seksuale gjatë luftës.

**Klevis Vagari:** Përshëndetje! Quhem Klevis Vagari, përfaqësoj Qendrën për trajnime dhe studime gjinore në Prishtinë. Faleminderit!

**Lumnije Grajçevci:** Përshëndetje! Jam Lumnije Grajçevci, përfaqësoj Organizatën e grave “Auroda” në Prishtinë.

**Nerimane Gërguri:** Ju përshëndes të gjithëve! Jam Nerimane Gërguri, përndryshe punoj në Ambasadën Amerikane, këtu në Prishtinë, por tani, sot në këtë mbledhje jam në kontekstin si familjare, meqenëse jam njëra prej nënave e cila gjatë luftës ka humbur burrin dhe vëllanë.

**Sakibe Doli:** Shumë vështirë pas kësaj me u prezentaur, por megjithatë na duhet. Sakibe Doli, përfaqësoj Shtëpinë e Sigurtë strehimore për viktimat e dhunës në familje.

**Suzana Berisha:** Jam Suzana Berisha, OJQ “Shpresa dhe shtëpitë e fëmijëve” Prishtinë.

**Flutura Xharra:** Jam Flutura Xharra, anëtare e Shoqatës së juristëve rinorë në Prishtinë.

**Ana di Lellio:** Profesore – KIJAC.

**Tahire Gashi:** Përshëndetje! Jam Tahire Gashi, përfaqësoj Shoqatën “Zana” nga Klina, e cila promovon dhe mbron të drejtat e njeriut, e njëkohësisht përparësi kanë të drejtat e femrave.

**Lize Marku:** Përshëndetje! Quhem Lize Marku, nga fshati Vitek, kryetare e Shoqatës – OJQ “Indira”, Komuna e Klinës.

**Fahrije Elezi:** Jam Fahrije Elezi, përfaqësoj Hendikosin në Kosovë, përndryshe jam asistente e Grupit të femrave me aftësi të kufizuara, Komuna e Prishtinës.

**Gjylfidane Morina:** Quhem Gjylfidane Morina, nga Shoqata e amvisave të Kosovës, Pejë.

**Florije Aliu:** Quhem Florije Aliu, vie nga Mitrovica. Jam koordinatore e projektit “Nënat kryefamiljare” e gjithashtu jam grua kryefamiljare apo nënë kryefamiljare. Bashkëshortin e kam të zhdukur gjatë luftës.

**Nuriye Ferati:** Përshëndetje! Jam Nuriye Ferati, përfaqësoj Shoqatën Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

**Ivan Kuzminović:** Swedish Helsinki Comitee

**Abdullah Ferizi:** Forum ZCD Kosovë.

**Cestin Hakman,** “Partners Kosova”....

**Hasti Istenjeu,** “Partners Kosova”...

**Shukrije Gashi:** Unë ju falënderoj të gjithave dhe të gjithëve. Po ashtu, falënderoj edhe stafin e “Partners Kosova” Hilmije Ramabaja, që është udhëheqëse e Programit të trajnimeve dhe Selvije Rashani që është udhëheqëse e Programit të iniciativave të qeverisjes vendore, Mentor Rushitin, udhëheqës i financave, Florent Hajrizin, udhëheqës i Programit të ndërmjetësimit, Besarta Vasija që është koordinatore e këtij Programi dhe të gjithë të tjerët, duke i përfshirë edhe përkthyesit të cilët e kanë një punë të madhe si dhe ata të cilët kanë siguruar logjistikën e mjeteve të zërimit e të tjera. Faleminderit! Tash do të vazhdojmë me këshillimin. Edhe një herë, dua të besoj se në ndërkohë do të vijmë edhe përfaqësueset e organizatave të tjera për arsye se një këshillim i tillë është me rëndësi, në veçanti, siç e thash edhe më herët, për gruan, e cila në Kosovë e përfaqëson pothuaj se mbi 50% të popullatës dhe do të ishte fatkeqësi e madhe që mos të marrin pjesë gratë në zhvillimet e tilla për faktin se gruaja ka qenë e atakuar trefish në të gjitha përpjekjet, në veçanti, gjatë luftës, edhe si nënë, edhe si kujdestare e shtëpisë, si bashkëshorte, por edhe si aktiviste. Andaj konsideroj se takimet për këshillime të tilla janë shumë të rëndësishme. Shpeshherë gjatë krejt pjesëmarrjes në këshillime që janë organizuar në gjithë ish-Jugosllavinë ka pasur kundërshti, mospajtime por edhe përkrahje dhe në të gjitha këto ngurrime, hezitime se a duhet marrë pjesë apo jo, unë kam zgjedhur se duhet të jem pjesëmarrëse, për faktin se dikush duhet ta nisë përpjekjen. Me këtë nuk dua të them se deri më sot s’ka pasur përpjekje. Në Kosovë, ka pasur përpjekje. Ka pasur përpjekje tek-tuk, kush më shumë e kush më pak, mirëpo të gjithë ne e dimë se Kosova në këtë rrafsh i ka dhe i ka pasur veçantitë e veta, nuk ka qenë lehtë që nën ndikimin ose nën administrimin e tri qeverive të ndryshme ndërkombëtare, e kam fjalën, dhe asaj vendore që shoqëria civile në mënyrë të duhur ta marrë rolin e prijtares për zhvillimet e tilla siç është, për shembull, edhe një nismë e tillë – përbalja me të kaluarën, përpjekjet që të shërohet e kaluara dhe që një e kaluar e cila me vete ngërthen shumë dhembje, kujtesë të dhembshme, që ka lënë shumë të vrarë mbrapa vetes dhe shumë vragë e plagë në mesin e të gjithë qytetarëve të komuniteteve të ndryshme, t’i lihet përsëri për barë gjeneratave që vijmë do të ishte e padrejtë. Prandaj, kam vendosur bashkë me të gjithë panelistët që janë këtu dhe përkrahësit e shumtë tjerë, të cilët nuk janë të pranishëm ose nuk janë të pranishme, që t’i bashkëngjitemi një iniciative në të cilën ka hapësirë për reflektim të ndryshëm. Në këtë përpjekje ka pasur kundërshti se a duhet të jetë themelimi i komisionit në nivel nacional apo rajonal dhe natyrisht se rruga nuk është e mbyllur, është e hapur. Kosova tani është shtet i pavarur, fatmirësisht dhe ne e dimë se gjithkund grupet më të atakuara kanë të drejtë dhe është e drejtë e tyre legjitime që ato të kërkojnë të drejtën e pronësisë në procese të tilla. Andaj, kjo është vetëm një mundësi e vullnetit të lirë që të fillohet me një diçka, ose iniciativë që është përmbajtësore dhe që ka për qëllim themelimin e një komisioni i cili do të bëhet nga ana e qeverive me qëllim që të vihet drejtësia në vend njëherë e përgjithmonë për të gjitha grupet e atakuara. Mirëpo, dihet se për t’u realizuar një iniciativë e tillë, ky është vetëm një proces, kërkohet shumë mund. Unë për themelimin e komisionit nuk

do të flas për faktin se janë këtu panelistët tjerë ose panelistet e tjera të cilat do të flasin për këtë çështje por do të ndalem më tepër në temën që e kemi emërtuar – Nevojat, pritjet e viktimave, të shoqërisë dhe drejtësia tranzicionale në sy të grave. Siç e thash edhe më herët, nevojat e viktimave janë të shumta. Duke filluar, thjeshtë nga mospërkrhja shpirtërore, sociale, morale, materiale e të tjera dhe po flas me theks të veçantë në Kosovë ku shoqëria e Kosovës është përballë përveç tjerash edhe me vështirësi të shumta pikërisht për faktin se është shtet i ri në ndërtim, në ndërtim e sipër dhe në rrugën që e ka zgjedhur për t'u shndërruar në një shtet të pavarur, përveç tjerash, është përballur edhe me imponime nga ana e bashkësisë ndërkombëtare me legjislacione të ndryshme të cilat kanë paraqitur sa përparësi aq edhe vështirësi, për faktin se ne të gjithë e dimë se Kosova për vite të tëra ka qenë në një okupim të rëndë, në veçanti dhjetëvjetëshi i fundit i para luftës, ku pjesa dërrmuese e shoqërisë së Kosovës ka mbetur jashtë institucioneve shtetërore dhe natyrisht në këtë përballje ka humb edhe shprehia për punë por edhe kanë munguar përvojat dhe njohuritë. Andaj, për t'u përshtatur menjëherë me legjislacione të cilat kanë ardhur nga shtete të ndryshme, ka qenë dhe do të jetë vështirë. Mirëpo, siç e thash edhe më herët, fatmirësisht shoqëria civile edhe para luftës në Kosovë po edhe tani ka qenë shumë e organizuar dhe nuk ka munguar asnjëherë angazhimi i shoqërisë civile. Andaj, edhe në këtë proces që është i vështirë, siç duket, përsëri shoqëria civile është ajo e cila merr rolin prioritar për t'u prirë proceseve të tilla dhe duke ditur të gjithë tani se ky është mision i shenjtë, kur iu takon kategorive më të goditura nga lufta e fundit në ish-vendet e Jugosllavisë, atëherë ne do të bëjmë çmos që t'i bashkëngjitemi një iniciative të tillë dhe të gjejmë hapësirë, të kemi vesh për të dëgjuar se ç'kanë për të thënë të gjitha viktimat, domethënë të të gjitha kategorive dhe në këtë rast po flas në veçanti për gruan për arsye se edhe ky këshillim më tepër i dedikohet grave. Ne të gjitha e dimë se numri i grave që kanë pësuar nga lufta është i madh dhe për përfshirjet e tyre është folur shumë mirëpo ndoshta nuk është folur gjithmonë aty ku kanë mund të kenë qasje pjesa dërrmuese e popullatës dhe e shteteve që kanë ndikim përkitazi me këtë çështje të forumeve të cilat janë të thirrura që të mbrojnë dhe të vënë drejtësinë në vend. Andaj, kemi konsideruar se as sot nuk është vonë dhe as nesër nuk është vonë. Më mirë është që të flitet ndonjëherë se sa mos të flitet asnjëherë. Përveç kësaj që e thash, dua të theksoj se në radhë të parë do të duhej që të krijohet një platformë ku të gjitha viktimat do ta kishin mundësinë që të flisnin zëshëm për nevojat e tyre, të gjitha nevojat e tyre si viktimat, siç e thash më herët, dhe që ato të gjejnë mirënjohje publike, të marrin mirënjohje publike dhe t'u njihet statusi i të qenurit viktimë, të jetë i pranueshëm si viktimë në këtë shoqëri, që ato të flasin zëshëm për të gjitha nevojat materiale, shpirtërore, morale. Dhe, meqenëse deri më tani nuk ka ndodhur diçka e tillë, ka pasur iniciativa individuale tek-tuk por të gjitha këto kanë qenë simbolike, prandaj kjo edhe nuk do të thotë se nuk do të mund të bëhet më shumë. Një mundësi për t'i ofruar këto ndihma, këtë formë të përkrahjes për viktimat, është edhe themelimi i një Komisioni të tillë, i cili, siç e thash më herët, fillimisht është në nivel rajonal, për arsye se iniciativën e ka marrë një nivel i tillë. Mirëpo, në proceset e tilla unë konsideroj se duhet pasur hapësirë për të gjithë. Nuk duhet pasur frikë nga kundërshtarët, nga ata të cilët nuk pajtohen me iniciativa të tilla. Aty, ku ka mospajtime, ka mundësi për gjenerime, për ide të reja për arsye se lufta që ka ndodhur në Jugosllavi i ka pas dhe i ka veçantitë e veta. Prandaj, edhe këshillimet e tilla duhet pasur hapësirë dhe qasje për të gjithë. Deri më tani mund të them lirisht se një pjesë e madhe e shoqërisë kosovare e ka përkrahur këtë iniciativë dhe ka bërë mirë. Nëse asgjë s'arrihet, të paktën është një mundësi më shumë që të kuptohet se çka është drejtësia tranzicionale, çka ofron drejtësia tranzicionale, çka ofron Koalicioni për KOMRA, trajnimet, format e

shpërndarjes së informatave, përkushtimin për emërtimin e viktimave, përkushtimin ndaj thjeshtë shkruarjes, ngritjes së legjislacionit për të gjitha kategoritë më të atakuar nga lufta, vetëdijesimi i shoqërisë në të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë për një çështje kaq të rëndësishme, e cila po të mos ndodhë do të jetë shkas që në të ardhmen e afërt përsëri të provohet me konflikte të reja ose destabilizim të vendeve dhe shoqërive veç e veç. Nevojat janë të mëdha. Deri më tani edhe mbi 17.000 viktima në krejt Jugosllavinë ose që ndodhen të pagjetur dhe përpjekjet duhet të vazhdojnë. Kurse, në Kosovë janë mbi 1.900 që ende nuk është zbardhur fati i tyre dhe mbi 400 mbetje, të cilat ndodhin në morgun e spitalit në Kosovë, në Prishtinë për të cilat lende nuk është bërë gjithçka e mundshme që ato të dihen se kush janë, të kujt janë. Të gjitha këto janë barrë e rëndë për shoqërinë dhe për të gjitha këto duhet bërë shumë, që të bëhet e mundshme një qasje njerëzore e meritueshme, ndaj të rënëve por edhe ndaj familjarëve të të rënëve veç e veç. Prandaj, konsideroj se iniciativat e tilla janë të nevojshme, bëjnë shumë për shoqërinë dhe nuk duhet pasur rezerva ndaj iniciativave të tilla. Pse është e rëndësishme që të ketë bashkëpunim ndër-rajonal? E ka arsyeshmërinë e vet. Të gjithë ne e dimë se trupat e viktimave janë bartur nga një vend në tjetrin, nga kryerësit e vrasjeve, nga kryerësit e veprave penale me qëllim që të zhduken gjurmët. Dhe, në gjetjen, zbulimin dhe zbardhjen e fakteve do të jetë pothuaj se e pamundur të bëhet diçka në qoftë se nuk do të ketë bashkëpunim ndër-rajonal. Në këshillimin e fundit që e patëm në Kosovë, para pak kohësh, ne kishim përfaqësuesin nga Bijelina, nga Bosnja i cili tregoi se së voni në Bosnje janë zbuluar se aty ka ndodhur një vrasje ose më mirë me thënë një masakër – masakrim i 55 trupave të qytetarëve shqiptarë që kanë ndodhur atje dhe mbetjet e tyre ose trupat e tyre janë bartur në Tetovë, në Maqedoni. Ky është vetëm një shembull i cili flet mjaft se sa është i nevojshëm bashkëpunimi i ndërsjellë. Në gjithë këtë proces, do të jetë e pamundur që të bëhet një trajtim i meritueshëm për të gjitha kategoritë në qoftë se me dëshmimin rreth ngjarjeve, rreth vrasjeve do të ngelet jashtë përfshirjes një nga kategoritë shumë të rëndësishme – kategoria e veteranëve të luftës. Nuk duhet pasur ngurrim në këtë. Dëshmimi është vetëdijesim i shkallës superiore për arsye se ofron mundësi që të gjithë ata që janë përfshirë në konfrontimet e ndërsjella dhe e dinë arsyen pse kanë qenë në pozicione të ndryshme, dikush në mbrojtje e dikush për okupim. Ata në një moment të caktuar, në rastin kur të pranojnë që të dëshmojnë, do të vetëdijesohen se sa e rëndësishme është kjo që t'i ndihmojnë proceset e tilla. Dhe natyrisht pranimi për dëshmim ndërthun në vete përveç vetëdijesimit dhe shprehjes së një morali, vullneti të mirë për t'i ndihmuar shoqërisë, edhe lehtësimin në presupozimet se në të ardhmen gjatë proceseve të gjyqimit do të ketë edhe falje për ta. Prandaj, të gjitha këto veprime janë shumë të rëndësishme dhe jemi të vetëdijshme të gjitha se në veçanti gratë, nënat, motrat, aktivistet, përfaqësueset e shoqërisë civile dhe po ashtu shtëpiaket e kanë një rëndësi të veçantë për kontributin e tyre në këtë proces, për arsye se edhe në të ardhmen e afërt, gjatë gjithë kohës, përsëri barra kryesore mbetet me gratë. Ato janë të cilat me sinjeritet i shtynë proceset përpara dhe asnjëherë s'ka munguar zëri i tyre i fuqishëm në këto procese. Ne të gjithë e dimë se numri i viktimave është i madh, sikur që e përmenda. Për shembull, në Kosovë janë mbi 14.000 viktima dhe natyrisht se në shoqëritë e pas luftës ku ka përballje me shumë probleme dhe ku qeveritë e ndërsjella nuk mundën, e nganjëherë u mungon edhe përvoja, që mirë t'i definojnë se cilat janë prioritetet. Do të ketë edhe përpjekje për të bërë një trajtim të merituar mirëpo ekziston edhe mundësia që gjithë të goditurit të mos e marrin thjeshtë ndihmën e merituar në format të cilat i përmenda, mirëpo kjo është çështje e cila ngel për tu bërë dhe sa do të bëhet e në ç'nivel do të bëhet, si do të bëhet, është deri tek shoqëria civile po e them meqë është prioritare në këtë lloj procesi që të angazhohet më shumë, të jetë më e zëshme dhe



të bëjë më shumë presion tek qeveritë vendore në Kosovë e gjetiu në mënyrë që në të ardhmen e afërt, së shpejti, t'i jepet prioritet një fushe kaq të rëndësishme në të cilën do të ketë edhe ligj, përkrahje ligjore për viktimat të të gjitha grupeve, do të ketë edhe përkrahje sociale – ndihmë sociale, morale, do të krijohen vende të punës për të gjithë ata që janë goditur. Prandaj na mbetet të shpresojmë dhe ne e dimë se shpeshherë forca, fuqia gjithmonë mbetet në anën e të fortit dhe ndoshta në procese të tilla dikush nuk do të trajtohet siç duhet, e këta zakonisht janë ato grupe të cilat janë në asistencë sociale, të cilat edhe sot e kësaj dite kanë ngelë jashtë kujdesit të qeverisë, shoqërisë dhe të gjithë neve. Për ta përfunduar prezantimin tim me kaq, edhe pse sigurisht kanë ngelur pa u thënë edhe shumë çka, për shkak të respektimit të minutazhës, atëherë unë po e lë këtu. Dhe për pyetje e komentime ju jeni ata të cilët jeni të mirëseardhur për të kontribuar dhe e keni fjalën. Kjo është një mundësi e hapur dhe jeni të mirëseardhur të paraqiteni me pyetje dhe komentime. Faleminderit!

**Besarta Vasija:** A ka mundësi që secili, kur të flet, të prezantohet se këtë jemi duke e incizuar dhe na nevojitet kjo për hir të transkribimit. Faleminderit!

**Veprorë Shehu:** Ju përgëzoj për iniciativën. Është një iniciativë që me të vërtetë ndërlihet dhe na prek të gjitha neve që jemi duke punuar në fushën e përkrahjes së femrave, posaçërisht viktimave të luftës. Gjatë prezantimit të Shukrijes, isha duke menduar për kohën e bisedimeve për statusin politik të Kosovës, atëherë kur Beogradi dhe Prishtina ishin duke diskutuar çështjen dhe gjëja se u fillua me çështje teknike dhe doli në statusin, definimin e statusit politik të Kosovës dhe që në atë kohë ndoshta ne si shoqëri civile është dashur ta përgatisim një platformë, sepse më pëlqeu shumë ajo që e tha Shukrija që duhet ta bëjmë një platformë ku do të futen të gjitha nevojat dhe të adresohen nevojat e viktimave, mënyra e zgjidhjes por edhe e palëve me interes dhe personave, institucioneve që e marrin zgjidhjen dhe përmbushjen e këtyre nevojave. Dhe, në vend që të bisedohet vërtet për këto pritje të viktimave, kompensimin e dëmeve të luftës e shumë çështje tjera thelbësore për qytetarët e Kosovës, vërtet është bërë një proces i cili nuk ka pas nevojë të bëhet me Serbinë për deri sa ky status u zgjidh me përkrahjen ndërkombëtare, gjë që më vjen mirë që definitivisht u zgjidh çështja e statusit, por ne tash duhet gjithsesi të fokusohemi drejtpërdrejt në përmbushjen e nevojave të viktimave që vërtet ky status tu ofrojë edhe kënaqësi qytetarëve të Kosovës dhe ta gëzojnë me të vërtet shtetin e vet. Unë desha të fokusohem, meqenëse i përkrahim viktimat e luftës, kemi edhe gra me të zhdukur, një numër shumë të madh të grave, ndonëse është edhe në Gjakovë Shoqata “Thirrjet e nënave” që merret vetëm me këtë çështje. Kemi edhe një numër mjaft të madh të grave që kanë humb djemtë, bashkëshortët e tyre gjatë luftës, madje kanë qenë dëshmitare të masakrimeve të anëtarëve të tyre të familjes, ngjarje mjaft rrëqethëse por jemi duke i përkrahur edhe femrat që kanë mbijetuar dhunimet seksuale gjatë luftës. Ne, si organizatë që prej 2006 kemi filluar me modifikimin apo plotësimin e Ligjit ekzistues për veteranët e luftës, për familjarët e dëshmorëve dhe për viktimat civile të luftës që edhe këto femra të trajtohen si viktimat civile të luftës, një gjë të cilën Bosnja e ka arritur. Organizata jonë simotër Medika Zenica në Bosnje e ka ngritur një fushatë atje para 2 vitesh dhe atë, mundem të them, menjëherë pas përfundimit të luftës kanë filluar me iniciativa të tilla, posaçërisht me fokus të posaçëm të viktimave që kanë mbijetuar dhunime seksuale gjatë luftës. Dhe, tek pas 5 a 6 viteve përpjekjesh, definitivisht kanë arritur që të fusin në ligj këto femra dhe ka filluar ky ligj të implementohet. Domethënë, ato gra dhe femra – vajza marrin asistencë, ndihma materiale si formë pensioni prej shtetit dhe kanë disa beneficoine të caktuara në çështjen e përkujdesjes shëndetësore, në çështje të arsimimit e tjera, po edhe përparësi në çështjen e punësimit.

Ne morëm një iniciativë të tillë, edhe me përkrahje të UNIFEM-it, do të thotë me zyrën në Kosovë dhe në përkrahje të Zyrës së Ombudspersonit mirëpo i rregulluam dhe i bëmë ato amendamentet e nevojshme por gjithmonë Qeveria jonë dhe organi legjislativ me prioritet të definimit të përpilimit të ligjeve që përmbushin paketën e Ahtisarit, kjo çështje ka ngelur anash. Dhe tash në diskutim me gratë e parlamentit që kanë marrë përsipër për me shty këtë çështje në parlament, do të thotë ka prioritete tjera. Sido qoftë ky është në procedurë e sipër. Por megjithatë unë kisha thënë se është mirë edhe përmes këtij koalicioni që të shtyhet kjo çështje. Ne veç i kemi dorëzuar dhe amendamenti veç është bërë. Kam dëgjuar prej disa deputeteve të Kuvendit të Kosovës që ka dal prej sirtarit të Ministrisë për Mirëqenie Sociale ky dokument dhe që do të procedohet në sektorin ligjor atje me ato aktet nënligjore të fillojë të përmbushet ligji në fjalë. Kam edhe shumëçka për komisionet e së vërtetës, por unë e pres pikën kur të vijmë te komisioni dhe drejtësia tranzicionale.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit Lola. Vetëm desha të shtoj edhe diçka që mu kujtua. Edhe një komponentë shumë e rëndësishme që më paska ikur e nuk e pasna theksuar më duket, është edhe çështja e ngritjes së memorialëve për të gjithë të rënët, të gjitha grupeve të viktimave, qoftë të rënët dhe ata të cilët e kanë mbijetuar vdekjen, domethënë edhe për të tillët, në forma të ndryshme, por në formë të organizuar, gjë e cila nuk është bërë deri më sot. Edhe kjo është një mirënjohje, një pranim publik për fatet e të gjitha viktimave dhe kësaj çështjeje duhet kushtuar shumë kujdes. Kaq kisha, meqë mu kujtua kjo. Faleminderit!

**Veprorë Shehu:** Te mirënjohjet dhe iniciativat që i bëjnë viktimat vërtet ndoshta të kenë atë krenarinë e mbijetesës, që është shumë me rëndësi që ne të respektojmë forcën e mbijetesës së tyre. Dhe, Shukrije që ta vërtetoj këtë, me të vërtetë është me rëndësi kjo dhe ne posaçërisht viktimat tona, do të thotë gratë me të cilat ne punojmë janë ndie shumë mirë atëherë kur themeluesja e organizatës tonë, nga Gjermania, zonja Monika Hauser ka fituar çmimin alternativ Nobel për paqe në Suedi në fund të vitit të kaluar dhe me të vërtetë me këtë edhe ne si aktiviste po edhe viktimat, do të thotë gratë, me të cilat punojmë, e kanë përjetuar si një mirënjohje të dhimbjeve dhe vuajtjeve të tyre, por edhe ne si mirënjohje për punën tonë dhe kontributin tonë për t'i përkrahur këto femra. Është me rëndësi që të ketë edhe iniciativa të tilla.

**Shukrije Gashi:** Urdhëroni, ju lutem! Ku janë gratë tjera?

**Sakibe Doli:** Do me thënë iniciativa të tilla, do të thotë ka pasur dhe ndoshta ato kanë mbetur në suaza të kornizave të lokaliteteve dhe për këtë arsye nuk është arritur ajo që është pritur, sepse e dimë që akoma kemi të zhdukur dhe ato mbetjet atje dhe unë mendoj se kjo është një iniciativë e nivelit më të lartë dhe shpresoj se ju do të gjeni forma dhe me këtë rast edhe unë do të bëja pyetje: si do të shtrini ju veprimtarinë tuaj nëpër lokalitete meqenëse ky është një organizim rajonal, për t'i përfshirë do të thotë të gjithë nevojtarët sepse ne e dimë që edhe në fshatrat më të larta ka njerëz që kanë të humbur e të zhdukur dhe nuk e kanë qasjen deri te ajo se si do të bëhet organizimi. Faleminderit!

**Shukrije Gashi:** Pyetja ishte shumë e qëlluar dhe sigurisht se do ta merrni përgjigjen më vonë. Ne do të përpiqemi ta respektojmë minutazhin dhe të mos dalim jashtë planifikimeve. Faleminderit!

**Nerimane Gërguri:** Kisha dashur të di diçka më shumë lidhur me aspektin ligjor, sa janë të vetëdijesuar këto femra – viktimat në këtë rast për ndihmën ligjore, e cila iu takon me të drejtë dhe çfarë është duke u ndërmarrë në atë aspekt, domethënë në platformë ligjore, a kemi ligj të caktuar i cili i përkrah dhe a është i njëjtë ai ligj për të gjitha kategoritë, sepse, sa e di unë janë

të ndara në disa kategori: veteranë të luftës, ushtarë të UÇK-ës e çka po di unë, e di që janë disa kategori. Cilat janë beneficionet, cilat i takojnë këtij grupi, posaçërisht këtij grupi të grave.

**Shukrije Gashi:**Do me thënë, edhe për këtë pyetje do ta merrni përgjigjen më vonë, në pjesët të cilat do të prezantohen në vazhdimësi për arsye se më shumë përkojnë me prezantimet që do të vinë në vazhdim dhe përgjigjen do ta merrni gjithsesi. Faleminderit!

**Eli Krasniqi:** Ndoshta edhe pyetja ime ka me marr përgjigje në pjesën tjetër, pas pauzës, por këtu në agjendë po shoh se është përkrahja morale, materiale dhe ajo ligjore, drejtësia tranzicionare dhe zëri i viktimave. Për sa të dëgjova unë ty Shuki, të kam dëgjuar edhe më herët, ndoshta mund të ketë përsëritje. Jam shumë e interesuar të di a është e mundshme me krijuar njëfarë forme ku ne mund të bisedojmë vetëm me të mbijetuarit e luftës dhe me shikuar ata çka po mendojnë për këtë punë. Domethënë me qenë një takim ku janë vetëm ata dhe nuk ka njerëz tjerë dhe si ata e shohin këtë, sepse ne e dimë, kemi pasur edhe takime tjera kur kanë qenë të mbijetuarit e luftës, të shoqatave të pagjeturve, por ndoshta me qenë pak më specifik në kuptimin që të ketë shtrirje pak më shumë në tërë Kosovën dhe mos të jenë ato format e organizimit si shoqata a organizata, sepse mua po më duket se atëherë po përfshihen të gjithë.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit, Eli! Po, gjithsesi se një mundësi e tillë ekziston dhe prandaj është mirë që të gjithë të interesuarit që qajnë hallet e këtyre kategorive të jenë të pranishme në tryeza të tilla për arsye se kjo është mundësia më e përafërt, më e drejtpërdrejtë që tu bëhet ftesë të gjithë atyre. Në të kundërtën, duke munguar në tryeza, siç mungojnë sot shumë gra, përfaqësuese të organizatave të ndryshme dhe fatkeqësisht edhe përfaqësuese të institucioneve të rëndësishme, siç është Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut bën që rastet e tilla të mos dëgjohen. Domethënë kjo është detyrë elementare, njerëzore, morale, obligative e shoqërisë civile dhe e gjithë shoqërisë kudo qoftë që përpjekjet e tilla të respektohen dhe të mos mungohet në to. Kurse, për këtë që propozove, gjithmonë është e mundshme. Secili prej nesh, qoftë si përfaqësues i organizatës, qoftë si qytetar i rëndomtë ka obligim moral dhe njerëzor dhe duhet të ketë vullnet të mirë që për kategori të tilla gjithmonë dhe në çdo kohë të ofrohen mundësi të tilla dhe ata të dëgjohen. Faleminderit!

**Nora Ahmetaj:** Eli, vetëm pak! Ne më vonë do ta shpjegojmë të gjithë procesin se si ka filluar, jo vetëm i konsultimeve, meqenëse është proces rajonal, prej një shteti siç ka qenë Jugosllavia që kanë dalë shtatë shtete tjera dhe po qe se vjen deri te formimi i këtij komisioni edhe vetë Komisioni ka me qenë shumë kompleks sepse është komisioni i parë në botë që është rajonal dhe jo nacional. Këto i shpjegojmë më vonë dhe mos tu bëjmë juve konfuz sepse gjatë gjithë ditës kemi me marrë shumë informata, mirëpo ndërhyri lirisht kur keni paqartësi, në mënyrë që edhe ne pastaj të kërcejmë prej një teme në tjetrën. Të përgjigjem Eli në këtë pyetje. Procesi i konsultimeve, tash kjo quhet KOMRA, quhet pra Komisioni rajonal, mirëpo procesi i konsultimeve për të drejtën transitore ka filluar diku kah mesi 2006 dhe ka filluar në Bosnje. Dhe konkretisht ka filluar procesi i konsultimeve me viktimat e luftës dhe me të mbijetuarit. Pastaj ka vazhduar. Aty është dashur shoqëria civile të prekë pulsën dhe me pa se çka mendojnë viktimat e luftës, domethënë a do të ketë bazë për krijimin e një komisioni të tillë a jo. Ka vazhduar në Kroaci, pastaj ka vazhduar në Serbi, në Mal të Zi dhe vetëm në Mal të Zi diku kah mesi i vitit 2008 është paraqitur nevoja për themelimin e Komisionit dhe de fakto komisioni është formuar në forumin e katërt....

**(Ndërhyrje)**

Më falni, është ky Koalicioni i organizatave dhe është formuar në fund të vitit 2008. Ku është esenca e konsultimeve? Esenca e konsultimeve është se këto konsultime bëhen me shumë segmente të ndryshme të shoqërisë civile, sikur sot që e kemi pasur me gratë, herën e kaluar që

e kemi pasur me artistë dhe ti ke qenë prezent, pastaj me të mbijetuarit dhe me familjarët e të zhdukurve. Me vetë procesin, ne gjatë këtyre konsultimeve po marrim informata, po marrim sugjerime të njerëzve dhe po mundohemi që me i shtjelluar ato sugjerime. Njëri prej sugjerimeve është edhe ky i juaji tash dhe ka sugjerime që edhe veteranët e luftës të marrin pjesë dhe të dëgjohet edhe zëri i tyre dhe kjo mundësi nuk është përjashtuar, kjo mundësi ekziston dhe parashihet që Koalicioni të vazhdojë konsultimet deri diku në vitin 2010, apo jo, dhe mandej do të vendoset. Dhe, për të mos kaluar prej temës në temë, më vonë do ta shpjegojmë edhe mbledhjen e nënshkrimeve dhe se shoqëria civile a do të jetë e gatshme t'i mbledhë nënshkrimet e duhura, që janë paraparë diku rreth 1.000.000 nënshkrime prej krejt shoqërive civile në të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, në mënyrë që ato nënshkrime t'i depozitohen parlamenteve, e pastaj çka vendosin parlamentet, është diçka që neve na mbetet si shoqëri civile vetëm me mbikëqyr, eventualisht me rekomanduar se çka me bë. Mirëpo, konsultimet Eli vazhdojnë dhe do të vazhdojnë dhe ato prekin shumë segmente të shoqërisë, nëse konsiderohet se pjesë të shoqërisë do të jenë edhe veteranët e luftës, edhe viktimat, edhe të mbijetuarit dhe tani të shohim se a mundet ky sugjerim të merret parasysh më vonë.

**Valdete Idrizi:** Pasi që jemi te konsultimet, desha vetëm edhe një informatë, ose jo informatë por një prej nevojave dhe kërkesave të organizatave joqeveritare dhe njëkohësisht edhe të familjarëve ka qenë që të organizohen konsultime edhe në nivelin lokal, pra jo vetëm në nivel nacional, si këtu sepse ka organizata në pjesë të ndryshme të Kosovës por edhe në regjione të ndryshme. Nesër, për shembull në Pejë organizohet nga Organizata “Syri i vizionit” një prej konsultimeve ku do të marrin pjesë edhe familjarët e atij regjioni, do të thotë përfshihen tri komuna dhe njëkohësisht edhe përfaqësues të institucioneve dhe unë personalisht do të shkoj atje që të bisedoj dhe shpjegoj pak qysh ka rrjedhë deri këtu i gjithë procesi.

Ta them këtë se ky është proces dhe asgjë nuk është e definuar. Mendoj se të gjitha prej neve duhet të mendojmë në atë drejtim dhe çfarëdo sugjerimi, çfarëdo lloj këshille, dileme, frike apo çka do qoftë që është mirë që ta shtrojmë dhe t'i ndajmë me njëra-tjetrën, sepse ky është proces dhe ne jemi ata që duhet ta drejtojmë këtë proces dhe gjithherë në përmbushjen e nevojave të viktimave sepse Shukrija e përmendi edhe më herët, sepse është arsyeja e vetë themelimit të këtij komisioni. Më falni, këtë e pata sa për ta shpjeguar. Faleminderit!

**Suzana Kunac:** Unë shkurtimisht e kam një koment në pyetjen e Elit. Ne para dy muaj kemi pasur konsultime me organizatat e grave në Kroaci dhe ajo që është treguar si praktikë e mirë deri më tani mund të jetë edhe një model i mirë që para çdo konsultimi të kemi një konferencë shtypi ku do të flasin viktimat lidhur me temën dhe për të cilën bëhet fjalë, nëse kemi të bëjmë me konsultimet rajonale dhe janë viktimat femrat, pra mund të jenë të pranishme dhe në ato konsultime të dëgjohen viktimat dhe ata t'i drejtohen opinionit. Kjo funksionon mirë në Kroaci, në të dy nivelet – lokal dhe qendror dhe kjo është ajo që kam dashur ta jap si kontribut sa i përket diskutimit dhe pyetjes tuaj.

**Shukrije Gashi:** Faleminderi, Suzi! Urdhëroni!

**Eli Krasniqi:** Më vjen keq nëse kjo që e them ndoshta është mungesë e informatës time, por po më intereson aspekti i metodologjisë, çka po ndodh pastaj pas këtyre konsultimeve, domethënë si po merren parasysh këto sugjerime dhe qysh po futen këto në sistem. Cila është metodologjia e përgjithshme e kësaj. Ndoshta edhe për këtë do të kemi përgjigje në seksionin kur flet Nora. Ndoshta kishte qenë mirë me filluar tash për këtë me Norën, sepse është mirë të dihet për çka KOMRA të diskutojë për nevojat.

**Shukrije Gashi:** Kjo është një pyetje me vend dhe ashtu sikur që tha edhe Nora, e theksoi edhe Valdetja dhe Suzi. Ky është proces dhe të gjitha sugjerimet që vijnë nga të gjithë të

interesuarit dhe nga të gjitha palët merren parasysh, futen në metodologjinë e punës e cila është analizë se çka është thënë prej secilës palë dhe gjithmonë merren parasysh të gjitha veçantitë. Ky është proces që ka kahje të modelimit. Vazhdimisht bëhet përpjekje që të kontribuohet në modelim. Çka do të thotë modelim? Të gjejmë modelin dhe metodologjinë e cila do të jetë mirë e baraspeshuar për t'i përfillur të gjitha propozimet, në mënyrë që të ketë qasje të drejtë për të gjithë. Do të thotë, është proces. Kurse, për ta shkoqitur edhe më shumë, do të merrni një përgjigje më përkatëse më vonë. Kaq kisha unë.

**Valdete Idrizi:** Veç ta plotësoj Shukrijen. U tha më vonë që vërtet është shumë kompleks për të gjitha këto qeveri, për të gjitha këto shtete që janë të kyçura dhe kjo veç e bën domethënë edhe më të vështirë këtë. Edhe unë edhe Shukrija jemi anëtare të Grupit Koordinues që është brenda Koalicionit dhe ne takohemi rregullisht dhe arsyeja pse takohemi është sepse prej të gjitha shteteve i sjellim të gjitha këto brenga edhe me shkrim, sepse të gjitha këto, sikur që e tha edhe Besarta më herët, të gjitha këto incizohen dhe të gjitha këto transkriptohen dhe të gjitha këto dokumente që i keni para veti po edhe shumë tjera që do të përkthehen më vonë publikohen. Pra, të gjithë këta zëra, gjitha këto sugjerime publikohen dhe dëgjohen. Mirëpo, sikur që e thash edhe më herët, ka shumë sugjerime, domethënë në forma të ndryshme. Kishim pasur qejf që ky komision se a do të arrijë me i zgjidhë dhe me e zbardhë të gjithë fatin e të zhdukurve, me i plotësuar të gjitha nevojat, por mendoj është ndoshta e pa mundur. Mirëpo, shpeshherë të gjitha këto nevoja, pasi që atje takohemi me përfaqësues të gjithë rajonit, shpeshherë janë të njëjta. Prandaj, veç desha të sugjeroj se sidomos në grupin koordinues ku ka përfaqësues prej të gjithë rajonit, aty është vendi ku ne në njëfarë forme pak a shumë edhe i dizajnojmë, sepse asnjëherë nuk kemi paraparë, unë nuk kam paraparë se do të ketë nevojë me organizua takime të përbashkëta, takime me artistë. Domethënë, absolutisht, hiq. Shpeshherë kemi menduar se do të kemi takime vetëm me familjarë dhe me organizata ekskluzivisht që merren me të drejta të njeriut, ndoshta jo të grave, jo si organizata çfarë është e imja në Mitrovicë që merret me serbë, me shqiptarë dhe është njëfarë urë lidhëse. Mirëpo, mendoj se secili prej nesh duhet ta luaj rolin e vet dhe do me thënë kjo është, që e thash edhe më herët, është proces dhe është goxha i ndjeshëm, kemi zëra që e përkrahin, domethënë, fuqishëm. Kemi zëra që janë ndoshta anë njëfarë konfuziteti se çfarë është ky komision dhe çfarë do të jetë ky komision, mos vallë shoqëria civile do ta themelojë, e absolutisht askund në histori, shoqëria civile nuk mund ta krijojë ose ta themelojë komisionin por ne si shoqëri civile e kemi nisur këtë proces dhe është mirë që të gjithë aktorët kyç të shoqërisë dhe secili të kyçet në proces dhe në një të ardhme të afërt, është një kohë aq e gjatë, aq edhe e shkurtë, e thamë edhe më herët, deri në fund të 2010 ka hapësirë për konsultime që t'ia japim njëfarë kahje dhe që këtë lloj metodologjie sa më shumë ta mprehim dhe drejtojmë në formën më të mirë të mundshme. Ndoshta ndaj të njëjtën keqardhje me Shukrijen se institucionet edhe pse e kanë përkrahur Forumin e katërt rajonal në Prishtinë, e ka hapur presidenti, ju e dini dhe disa prej jush keni qenë prezent, ministrja e Drejtësisë ka qenë aty, mirëpo jo gjithë herë mbërrin me qenë këtu me neve dhe me dëgjua. Dhe, e jona është që vërtetë ne dëshirojmë me i shkruar të gjitha dhe me i pa të gjitha transkriptet, që është do me thënë njëfarë obligimi që të informojmë për të gjitha detajet, për të gjitha zhvillimet. Nuk dua të them se nuk donë me përkrah, sepse me të vërtetë është shumë vështirë me garuar me të gjitha këto prioritete dhe me të gjitha këto telashe me të cilat po ballafaqohemi ne si shoqëri dhe njëkohësisht si qeveri por konsideroj se gjithsecili prej nesh duhet të bashkëpunojmë dhe të jemi të hapur e t'i themi të gjitha këto, ndoshta të gjitha ato dyshime, apo të gjitha këto sugjerime. Faleminderit!

-----

**Shukrije Gashi:** A po fillojmë? Meqenëse Sesionin e parë ishte shumë dinamik, ndoshta më dinamik se që kemi pritur, e që është shumë mirë, ndoshta vetëm ishte dashur që ne të fillojmë, e ky është mendimi im, të flasim në sesionin e parë para se të dalim tash në dy pika tjera: – për nevojat e viktimave dhe pse shoqëria civile është me rëndësi me u kyç në procesin në këtë koalicion për themelimin e Komisionit të pavarur. Ne kur biseduam, vërtet Shuki, por edhe Gazmiri i theksuan përvojat e vendeve të tjera në lidhje me themelimin e komisioneve të së vërtetës, e në disa shtete quhen edhe komisione të vërtetës dhe për amnisti. Mirëpo, ne këtu po flasim vetëm për komisione të së vërtetës, domethënë të gjetjes së fakteve dhe unë në ndërkohë në këtë Sesion unë në përgjithësi do të shpjegoj pak se si ka zgjat procesi dhe si ka filluar e si ka zgjatur në të gjitha vendet e rajonit duke e përfshirë edhe Kosovën. Pastaj, edhe zonja nga Kroacia do të flasë se pse është i domosdoshëm ky komision, po qe se formohet dhe çka mund të bëjë konkretisht shoqëria civile që me i shty qeveritë në rajon për ta marrë shumë seriozisht punën e themelimit të Komisionit dhe për modalitetet, atëherë le të mendojnë ata, mirëpo ne gjithmonë do ta kemi rolin, si e tha edhe Shuki, këshillues, sugjerues dhe do të japim edhe rekomandime. Procesi i konsultimeve, me të drejtën transitore e cila nënkupton të drejtën, që nuk është ndonjë formë speciale e së drejtës, por kryesisht merret me gjetjen e fakteve në shtetet të cilat kanë kaluar një kohë të madhe, një kohë të gjatë në konflikte të armatosura ose edhe në luftë, ku popullata është shtypur në mënyra të ndryshme. E drejta transitore i përmban pesë komponentë dhe unë tash po i referohem Qendrës Ndërkombëtare për të Drejtën Transitore. Janë disa komponentë dhe komponentë e parë është që pas konflikteve, meqenëse sistemet e sigurisë, që kanë qenë represive të reformohen, sepse pa u reformuar sistemi i sigurisë nuk mundet ai shtet të kujdeset për qytetarët e vet. Komponentë tjetër janë riparimet. Ne biseduam dhe i prekëm pak problemet e viktimave dhe të familjarëve të viktimave të cilat dalin nga lufta dhe cilat janë nevojat e tyre. Për këtë komponentë do të bisedojmë pak më gjatë edhe gjatë konsultimeve – pse është me rëndësi viktimat dhe familjarët e viktimave të marrin pjesë në këto konsultime, nga se qëllimi është që ne të dëgjojmë prej juve, qoftë si përfaqësues të shoqërive civile apo edhe përfaqësuesve të familjarëve të zhdukur për atë se cilat janë nevojat konkrete tuaja, në mënyrë që ne pastaj t'i adresojmë ato kur të fillojmë ta përpilojmë modalitetin për një komision të mundshëm rajonal dhe t'i paraqesim rekomandimet konkrete Qeverisë ose Parlamentit të Kosovës. Gratë.- Pse gratë? Sepse, gratë janë pjesë përbërëse dhe vitale e shoqërisë, edhe me të drejtën ndërkombëtare edhe humanitare. Të drejtat e grave shkelen jo vetëm pse janë si qëllim ose tragjet direkt i regjimeve dhe në mënyra të ndryshme shkelës të drejtave të tyre edhe fizike edhe psikike. Mirëpo, është edhe një komponentë tjetër e tyre, të cilën e dini shumë mirë, është dhunimi. Dhe gratë patjetër duhet me qenë ndoshta edhe si udhëheqëse i të gjitha këtyre proceseve nga se ato më së miri e dini çka iu nevojitet atyre. Ato janë viktimat të dyfishta dhe kjo pjesë përbërëse është komponentë kryesore e të drejtës transitore pa të cilën neve patjetër duhet ta diskutojmë. Komponentë tjetër, janë përmendoret dhe memorialet. U cek se viktimat duhet të dihen me emra dhe mbiemra dhe jo me numra dhe jo të adresohen si viktimat vetëm për kampanjë politike e të manipulohet me numrin e tyre, por duhet që shteti të merret me sigurimin e një dinjiteti së paku moral e pastaj edhe të merret me familjarët e tyre. E përmenda sistemin e gjyqësisë dhe krejt kjo, cila do të ishte për shembull, ose për ta shpjeguar pak më thjeshtë: pse një komision i të së vërtetës në rajon kishte me qenë i rëndësishëm për të ardhmen? Po qe se komisioni, ashtu si ne mendojmë, të jetë i pavarur rajonal, ku të gjitha viktimat do të trajtohen njëjtë dhe atëherë me të mbijetuarit të organizohen dëgjime publike ashtu sikur që janë organizuar edhe në disa vende. Kjo varet edhe prej specifikave të një rajoni, populli apo një kulture. Qëllimi tjetër është që të ngritët vetëdija e

popullatës së re, të atij populli, konkretisht fëmijët tanë dhe të ardhmen ta shohin përmes medieve se çka e kush ka bërë në Kosovë dhe të mos monopolizohet vetëm me ndjenjën e viktimit mirëpo të rinjtë ta shohin se si të parandalohet një konflikt tjetër i ngjashëm në rajon. Do të thotë jo vetëm këtu, por edhe në rajon. Do me thënë, ky është qëllimi tjetër. Prandaj, duke u bazuar në këto komponenta dhe në të drejtën transitorë, Fondi për të Drejtën Humanitare, konkretisht, që është në Beograd dhe në Prishtinë, si organizatë jo qeveritare dhe Dokumenta nga Zagrebi, që në fillim ka qenë një Organizatë për hulumtime të krimeve nga Sarajeva, e kanë iniciuar këtë proces me diskutime. Kjo ka filluar në Sarajevë me diskutime me shoqëritë civile dhe viktimat e luftës me pa se cili është mendimi i tyre, a pajtohen ata me një themelimi të mundshëm të këtij komisioni nga se do të flitet kryesisht për pjesën e cila më së shumti ka qenë e diskriminuar në secilën shoqëri në rajon. Edhe pse nuk është biseduar në fillim për komision. Është biseduar vetëm për idenë se a kemi nevojë neve, duke pasur parasysh se edhe Tribunali i Hagës po edhe gjyqet për krime të luftës kanë qenë shumë të ngadalshme e nganjëherë drejtësia është shumë e vonshme ose jo të gjitha viktimat kanë qasje në ato gjykata, por edhe frika e dëshmitarëve që të dëshmojnë në këto gjykata, dhe duke pasur parasysh të gjitha këto fakte, do të themi se a do të ishte mirë apo jo me u iniciuar puna e ndonjë komisioni. Konsultimet kanë vazhduar edhe në Kroaci, kryesisht kanë filluar në Sarajevë e në Zagreb, e pastaj edhe në Beograd, por aty janë ftuar numër shumë i madh i përfaqësuesve të shoqërive civile. Më vonë, do ta diskutojmë edhe punën pse qeveritarët ose përfaqësuesit e qeverive nuk janë ftuar. Ka pasur aty-këtu edhe përfaqësues të qeverive që janë ftuar, por këtë pyetje më vonë do ta shpjegojmë më detajisht me Vepronën. Pra, konsultimet kanë filluar në vitin 2006 e ne tash jemi në vitin 2009, do me thënë që 3 vjet jemi vetëm në konsultime, por ideja e formimit të koalicionit për KOMRA definitivisht është qit në tavolinë në Podgoricë në vitin e kaluar dhe pastaj është marrë vendimi me u themeluar në Prishtinë, në tetor të vitit 2008. Struktura e pjesëmarrësve ka qenë e ndryshme. Mundem me thënë se, e di rastin e Serbisë por edhe të Kosovës, e ndoshta edhe Vesna e di më mirë si ka qenë në Kroaci apo Bosnje, mediet nuk kanë qenë shumë të involvuara ose në njëfarë mënyre e kanë injoruar këtë proces qysh prej fillimit. Kjo vlen sidomos për Serbinë. Arsyet i dinë ata. Mirëpo mediat janë si mjet shumë i mirë për ngritjen e vetëdijes së popullatës, të shoqërisë civile por edhe të qeveritarëve që ky proces të shkojë pak më shpejt. Mediat deri tash nuk e kanë luajt si duhet rolin e vet. Në këto procese, konsultime, për shembull për faktin në Serbi, ka pas edhe veteranë të luftës të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë pranuar se me gjithë dëshirë do të marrin pjesë në këto konsultime në komisione kur të vijë koha dhe do të kërkonin edhe falje, po që se paraqitet nevoja. Eli e bëri sot një pyetje, po më duket lidhur me pjesëmarrësit dhe cilat segmente të shoqërisë do të merrnin pjesë. Ka diskutime dhe kjo do të merret edhe në bazë të sugjerimeve që vijnë prej jush se a duhet veteranët e luftës të marrin pjesë në këto konsultime dhe të japin kontributin e tyre, që do të thotë janë të pashmangshme. Është edhe një pyetje, për të cilën ndoshta do të flasim pak më vonë më gjerësisht, çka shoqëria propozon që ky komision po që se themelohet a duhet që komisioni i së vërtetës t'i hulumtojë edhe shkaqet e luftës. Kjo mund të jetë shumë problematike por jemi në diskutim e sipër dhe për këto çështje, gjatë diskutimit me ju dhe me Këshillin koordinues e me ekspertë tjerë, që nuk e përmenda, sepse tërë kohën jemi në përcjellje por edhe në njëfarë mbështetjeje prej qeverive perëndimore, prej Komisionit Evropian dhe shtytësi kryesor ndoshta financiar i këtyre proceseve është Mbretëria e Holandës. Prandaj, do të dal prej teme në temë. Kjo struktura e konsultimeve në njëfarë mënyre, në të gjitha vendet ka qenë e njëjtë dhe përfaqësuesit kanë qenë pjesëtarë të ndryshëm të shoqërive civile dhe të familjarëve të zhdukur. Ka përplasje të ndryshme, sidomos ka pasur përplasje

edhe në Bosnje me nënat e viktimave të Srebrenicës, sepse ata kanë kërkuar që në asnjë mënyrë për shembull të mos ballafaqohemi me dhunuesin ose me kriminelin i cili ka qenë përgjegjës për gjenocidin atje. Ka pasur përplasje edhe në forumin e katërt, që është mbajtur në Prishtinë mirëpo në parim Qeveria e Kosovës, ose në parim Presidenti, ministria e Drejtësisë dhe zëvendëskryeministri Manaj kanë qenë në hapje të këtij forumi dhe në parim e kanë përkrahur idenë dhe kanë treguar se janë të hapët për fillimin e procesit, mirëpo tash shihet se si ka me shkua rrjedha e diskutimeve dhe konsultimeve deri në fund të vitit 2010.

Ndoshta do të ishte mirë që gjatë diskutimeve sot dhe ju filluat shumë mirë me i dhënë disa ide dhe me i prekur disa pjesë vitale, për shembull të arsyeshmërisë pse koalicioni ekziston dhe çka duhet tutje të bëhet. Ndoshta më së miri kishte me qenë që ne sot të mbledhim prej jush, edhe prej juve që punoni me viktimat direkt dhe me gratë e dhunuara, edhe me familjarët që jeni edhe vetë familjarë të viktimave të zhdukur ose të vrarë, ju të na jepni ne sugjerime dhe ju të na tregoni ku mundemi ne të adresojmë dhe çfarë strategjie ne mundemi me bë në mënyrë që në konsultimet e ardhshme... sepse mos të harrojmë secili vend në rajon, edhe pse kemi dal krejt prej një shteti i ka specifikat e veta. Ato që munden me u kërkuar dhe janë kontestuar se në Kosovë nuk munden me qenë, në Kroaci ose në Serbi ose në Bosnje, kështu që pas këtyre konsultimeve ne mendojmë se në mënyrë shumë të denjë me i paraqitur ato sugjerimet, frikat tuaja në mënyrë që të konsultohemi dhe ta përpilojmë një strategji më të mirë. Prandaj, në momentin kur ne ta kemi një format të këtij koalicioni, që shoqëria civile e paramendon t'ia parashtrorj të gjitha qeverive në rajon, në mënyrë që të mos u lëmë atyre hapësirë për të mos e pranuar idenë, por që ato janë çështje politike në të cilat neve nuk mundemi me hy. Tash për tash e jona, si shoqëri civile është ta përgatisim terrenin, të parashtrorjmë pse është e nevojshme për viktimat e luftës dhe për viktimat e këtij rajoni qoftë të gjallëve qoftë edhe të atyre që janë të vdekur dhe pse është i nevojshëm ky proces, e çka bëhet më tutje, mbetet vendimmarrëse në qeveri të vendoset. Ne do të kemi gjithmonë rolin e mbikëqyrësit, dhënies së rekomandimeve dhe shtytës – presionit të madh që duhet ta kryejmë në Qeveri. Nuk po dua të hy në aspektin politik. Gazmiri e shpjegoj se komisionet e së vërtetës në vende të ndryshme të botës funksionojnë konform situatave që i kanë pasur brenda. Ne nuk mundemi të kërkojmë të formohet një komision sikur në Afrikën Jugore edhe pse ka qenë komision shumë i suksesshëm ose një komision sikur në Çile, ose në Peru. Megjithatë, ky është komision rajonal dhe mos të harrojmë se konflikti në mes Serbisë dhe Kosovës në njëfarë mënyre është i ngrirë nga se Serbia është i vetmi vend në rajon por edhe Bosnja që nuk na kanë pranuar dhe do të jetë shumë – shumë vështirë se si parlamentet dhe eventualisht qeveritë çka do të bëjnë për ta tejkaluar këtë problem. Mirëpo, munden, qysh në fillim mos me pranuar idenë dhe ne duhet të jemi të përgatitur edhe për këtë, të them, vendim, ide ose çfarëdo që vjen prej tyre, por të mos harrojmë edhe komponentë tjetër – ne jemi mësuar në Ballkan, ose historia na ka mësuar që gjithmonë me punuar me shtytje të madhe të bashkësisë ndërkombëtare. E thash edhe më përpara se Bashkësia Evropiane dhe komuniteti ndërkombëtar janë shumë pro këtij procesi. Mendimi im personal është, jo i koalicionit ose i KOMRES që është më mirë ne vetë me qenë gjenerator të kësaj ideje dhe jo me prit me ardhur bashkësia ndërkombëtare me na qit para aktit të kryer ose jo neve por qeverinë dhe me thënë ose pranoni se ndodh që edhe ajo do të ndodh në një të ardhme të largët, jo vetëm në Qeverinë tonë por në të gjitha qeveritë në rajon, ose në parlamentet. Mirëpo, ajo është pjesë që i takon politikës, kurse e jona është sot që të diskutojmë shumë haptazi për të gjitha frustrimet, hezitimet, frikën e juaj dhe është mirë që mu sot ta de batojmë këtu dhe ato ne do t'i marrim parasys, do t'i adresojmë dhe përpilojmë analiza dhe strategji se çka tutje të bëjmë, por në asnjë mënyrë të drejtat tona që na takojnë nuk



mundemi t'i neglizhojmë e as anashkalojmë për hir të formimit të ndonjë koalicioni, por duhet patjetër t'i adresojmë të gjitha ato në mënyrë që të mos dalim në të ardhmen para një akti të kryer. Nuk po vazhdoj më tutje. Ne do të flasim por edhe do t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja. Unë tash po ia jap fjalën zonjës nga Kroacia Vesna. Më fal, Suzana e cila do të na tregojë... Ok, e bëra një gabim në prezantim. Pra, Suzana ndoshta do ta tregojë pse është KOMRA dhe pastaj ne vazhdojmë me diskutime. Më parë, sepse harrova të tregoj, ne do ta shohim një film. Besarta, është për Perunë a po. Do të thotë Komisioni i pavarur në Peru. Filmin do ta shohim më vonë e pastaj vazhdojmë dhe veç do të mundeni të bëni pyetje. Faleminderit!

**Suzana Kunac:** Faleminderit, kolege! Unë ndjej nevojë t'ju përshëndes dhe kam nderi e veçantë të jem sot këtu së bashku me ju dhe mendoj që jemi këtu për të paraqitur atë dimensionin rajonal të konsultimeve të sotme dhe të përcjellim në njëfarë mënyre përvojat e konsultimeve që në maj (do të tentoj të flas pak më ngadalë) në Kroaci kemi biseduar për këtë temë. Mendoj se së pari duhet ta paraqes motivin tim pse jam kyçur në këtë proces dhe për ç'arsye mendoj se KOMRA është një nismë e rëndësishme. Pikërisht, në Prishtinë, në forumin e parë rajonal, kam pasur rastin të bisedoj me të rinjtë dhe atë që më kanë thënë të rinjtë atëherë, të cilat nuk janë pjesëmarrës të luftës as viktimat të luftës, ata më kanë thënë se nuk mund të jetojnë pa kuptuar se çka ka ndodhur në këto hapësira dhe pa i ditur faktet, pa qenë të lirë nga stereotipi i paragjyqimeve dhe urrejtja ndaj të tjerëve dhe nga gënjeshttrat që paraqiten në media dhe se ata janë përgjegjës për t'i kontribuar përcaktimit të fakteve. Pra, sikur dikush që është 15 vjet aktiviste dhe di për punën e shumë organizatave të grave, kam konsideruar se përgjegjësia jonë është shumë e madhe edhe në raport me të rinjtë dhe është kjo një detyrë shumë e rëndësishme e Komisionit të ardhshëm që të mos të ndodhë sikur që ndodhë sot në Bosnje e Hercegovinë që secili entitet ta ketë historinë e vet – boshnjakët, kroatët dhe serbët, historinë e tyre, apo siç është rasti në Vukovar ku janë të ndara paralelet, pra fëmijët e rinjtë që janë një qytet, qytet i vogël dhe gjenden me mure të ndara. Unë nuk dua të jetoj në një shoqëri dhe qytet të tillë dhe nuk dëshiroj të jetoj as në një ambient a mjedis të tillë. Pra, këtu e shoh unë atë përgjegjësinë time primare. Dhe, një çështje tjetër që sipas meje është me rëndësi dhe qëllim që është edhe sot, ai qëllim i ngushtë, do të flasim pak për mandatin. Organizatat joqeveritare të grave në konsultim në Kroaci, të gjitha jemi ballafaquar pas një kohe shumë të gjatë që të fillohet (biseda) lufta me gratë që kanë përjetuar keqtrajtime seksuale dhe ky ballafaqim nuk ka përfunduar. Nuk e dimë se çfarë gjykimesh dhe nëse janë zbatuar proceset gjyqësore për këtë dhe ajo që më ka shokuar gjatë këtij procesi është se viktimat vetë janë lënë në harresë, se për ta, tash për tash nuk ka drejtësi dhe në shumicën e rasteve një grua Lubica që ka humbur vajzën 19 vjeçare në Sisak, në vitin 1991 as sot e kësaj dite nuk e di se kush e ka bërë këtë vepër dhe jo vetëm kaq, por ajo është për herë të dytë viktimë. Asaj shteti kroat ia paguan kompensimet gjyqësore dhe e ka humbur çdo kontest dhe është e palejueshme që për këtë të heshtim dhe nuk lejohet të kihet një qëndrim i tillë ndaj viktimave. Pra, janë këto disa arsye personale, për të cilat unë jam sot këtu me ju dhe mendoj se është shumë me rëndësi që jemi tubuar sot këtu në Prishtinë dhe mund të parashtrojmë pyetje dhe të shohim se si do to duket tutje ky proces dhe kam dashtë të them diçka në fillim, që secili person këtu ka përgjegjësi të madhe. Është ky një proces i ndërlikuar. Pra ndodhin në vende të ndryshme me kontekste të ndryshme dhe njohuri të ndryshme. Ka një angazhim dhe materiale të mëdha të njerëzve që janë në Këshillin koordinues. Është e jona që ne të parashtrojmë pyetje. Ky proces duhet të jetë transparent dhe duhet secili të paraqet përvojën e vet, të japë maksimumin dhe unë e di që ju jeni të vyeshme dhe persona me përgjegjësi. Ajo që është me rëndësi, është se mandati i Komisionit, të them që në fillim dhe do të përgjigjem se për ç'arsye është ky

komision, unë besoj në këtë komision për të vërtetën dhe drejtësinë dhe në mandat të përfshihet edhe dhuna, pastaj në mandat ka dilemë nëse do të flasim për shkaqet dhe kontekstin historik dhe mendoj se kjo është me rëndësi, por duhet të kihet parasysh se komisionet të themelohen ashtu që të punojnë dhe punojnë në kohë të caktuar që është i madh numri i viktimave dhe shkelja e të drejtave dhe do të jetë një pyetje e veçantë se nga të gjitha shkeljet e rënda çka do të mund të përfshihen në kuadër të mandatit të Komisionit. Unë sot jam këtu para jush dhe do të angazhohem gjatë tërë këtij procesi që dhuna, si krim lufte, të hyjë në mandatin e Komisionit dhe besoj se kjo është me rëndësi sepse pa këtë ky komision nuk do të mund të jetë në atë dimensionin e duhur. E kam edhe një vërejtje, të e kisha theksuar, tashmë nuk është fillimi por kjo po zgjatë që një kohë, pra ka të bëjë me këtë se Tribunali i Hagës që nga viti 1993, me presion të organizatave amerikane dhe ekspertëve të drejtësisë e kanë shpallur dhunimin si krim kundër njerëzimit. Ajo që e kanë tërhequr vërejtjen “Gratë në të zeza” dhe shumë organizata tjera të grave nga rajoni i janë bashkuar Letrës kundërshtuese me rastin e gjyqimit të Karaxhiqit kur dhunimi nuk ka hyrë si krim lufte. Gjatë agresionit serb në Bosnje e Hercegovinë, kjo është nga deklarata e “Grave në të zeza” me të cilën unë pajtohem dhe mendoj se është një bazë e mirë për debat të mëtejshëm. Pra, dhunimi nga formacionet ushtarake e paraushtarake, e shfrytëzuar si instrument i spastrimit etnik dhe i gjenocidit, i orientuar kundër popullatës boshnjake dhe veçmas kundër femrave boshnjake. Krimet ndaj femrave kanë mbetur të paemëruara si të tilla. Përrjashtimi i dhunimit ndaj të drejtës ndërkombëtare dhe mendoj se kjo nuk do të ndodhë me këtë rast, paraqet një plagë të rëndë për viktimat, të përjashtohet shkelja dhe gjinia në raport me gjininë paraqet një shkelje për të gjithë personat nga të gjitha këto vende dhe rajone të cilat kanë qenë të përfshira në konflikte ushtarake. Pra, dimensionin gjinor i luftës ekziston. Për këtë “Gratë në të zeza”, në të vërtetë kanë shkruar harta të tëra se si dhe në çfarë mënyre gratë janë viktimizuar si pjesë e një politike gjenocidiale dhe e dimë që vetëm një rast në Hagë tani është procesuar dhe ky është rasti i Foqës dhe është shumë pak. Pra, të sjell përfundimin e Kroacisë që edhe ne kemi ngecur në këtë aspekt 5-6 vjet pa nismë për KOMRA që ky rrëfim është heshtur dhe heshtet për këtë. Mendoj se kemi këtu sot rastin të vazhdojmë aty ku kemi ngecur. Tani do t’u them pse më gëzon kur flas për Komisionin për të drejtën dhe të vërtetën. Kjo më bën sepse dallimi themelor në mes të Komisionit për të vërtetën, drejtësinë dhe procesit gjyqësor është pikërisht kujdesi ndaj viktimave. Pra, nuk do të ndodhë, siç e dini, dhe gratë që merren me keqtrajtim seksual dhe viktimat që viktimizohen 3, 4 deri në 7 herë procesi të zgjasë me dhjetë vite dhe kurrë mos të realizohet drejtësia dhe mos të ekzistojë ajo që është me rëndësi, kurrfarë mbështetje psikologjike për viktimat që çdo dëshmi është traumë e re dhe hapje e një përvoje të vështirë përkatësisht të një ngjarjeje të jetës së tyre. Pra, Komisioni duhet të jetë një forum, një organ ku viktimat do të jetë në epiqendër dhe vëmendja ndaj viktimës do të sigurohet. Mendoj se Eli, në fillim, e tha atë se në aspektin lokal duhet të bëhet dëgjimi i viktimave. Dhe, për këtë pajtohem, por kjo duhet të bëhet në raport me nevojat e viktimave. Pra, mbështetja psikologjike duhet të sigurohet dhe njerëzit pas kësaj do të ndihen më mirë sepse e kanë ndarë me dikë të vërtetën e tyre dhe ajo përse janë të rëndësishme për Komisionin dhe për këtë jam e bindur thellë, është që Komisioni të përcaktojë zyrtarisht të vërtetën, pra të përcaktojë gjendjen faktike që më vonë mbetet si dokument për të gjithë ne dhe në njëfarë mënyre i detyrueshëm dhe viktimat me këtë e dinë të vërtetën, viktimat e dëshmojnë këtë, mirëpo deri sa kjo të bëhet zyrtare, për ta nuk përfundon procesi i shërimit të plagëve dhe këtu është ai roli shumë i rëndësishëm i funksionit të Komisionit. Përveç kësaj, disa komisione, siç e tha mirë Bekimi dhe mendoj se kjo neve nuk do të na ndodhë, nuk kanë kontribuar në atë pjesën e përgjegjësisë.

Unë konsideroj se Komisioni i ynë, nëse arrijmë ta themelojmë, kur të përcaktohen faktet dhe të dihen kryerësit, pra kur të kemi një situatë që të kërkohet përgjegjësia, mendoj se ky është dimension i rëndësishëm për viktimat dhe kështu e përjetojnë drejtësinë. Po ashtu, për viktimat është shumë me rëndësi të dinë nëse donë të falin, pra nëse flasim edhe për atë që kryerësve duhet t'u falet, ka mundësi të bëhet kjo por jo pa viktimat. Pra, viktimat duhet ta dinë kujt dhe përse i falet por jo si Vera Solar që nuk e di se kush e ka bërë vrasjen e vajzës së saj 19 vjeçare. Mendoj se kjo është me rëndësi për këtë komision, pa marrë parasysh nëse do të shkohet në ndjekje penale, pra përmes gjyqimeve dhe ky proces është shumë i rëndësishëm. Komisioni ka një rol shumë të rëndësishëm dhe kur flasim për pajtimin, me rastin e përcaktimit të fakteve mendoj se kjo do t'i kontribuojë të ardhmes dhe do të jemi të gatshëm ta përkrahim dhe do të mund të jetojmë në paqe. Unë mendoj se pikërisht ky proces është proces i ndërtimit të paqes dhe të them në njëfarë mënyre secili të ballafaqohet me krimet e veta dhe në njëfarë mënyre të pranojmë se në secilën palë të luftës ka pasur krime ndaj popullatës civile dhe në njëfarë mënyre të solidarizohemi me viktimat e të tjerëve dhe kjo është mënyra e vetme që nesër të gjithë së bashku të kemi mundësi si pjesë e Bashkimit Evropian të jetojmë në paqe dhe në një rajon stabil. Përveç kësaj, Komisioni ka një rol shumë të rëndësishëm dhe kjo është nxjerrja e rekomandimeve. Pra, në ç'mënyrë institucionet do të ndryshojnë. Reformat strukturale janë të rëndësishme sepse ato prodhojnë dhunë dhe këtë e dinë më së miri gratë dhe femrat, në çfarë mënyre reformash dhe në ç'mënyrë shoqëria e ardhme do të ndërtohet që krimet dhe dhunimet e tilla kurrë mos të përsëriten. Pra, kjo do të ishte në pika të shkurtra se për ç'arsye mendojmë kështu. Unë këtu kam edhe Prisilla Hayner, një autore dhe mendoj se edhe ju e keni këtë material. Është një material inspirativ dhe unë ju motivoj që këtë material, që Këshilli koordinues e ka përgatitur, ta lexojmë sepse për këtë shërben. Aty tregon se ku ka arritur ky proces i konsultimeve dhe si e shohim në këtë në rajon. Mendoj se kjo çdo herë ndryshon. Pra, procesi i konsultimeve është duke vazhduar në të gjitha vendet në nivelin lokal dhe nacional. Bekim, ju që jeni në Këshillin koordinues, nëse nuk them diçka të saktë, të më përmirësoni, por gjithsesi ajo që mendoj është se deri tani jemi marrë vesh dhe se parlamentet do të duhej të përfshihen në procesin përkatësisht marrjen e vendimit për themelimin e Komisionit sepse është dëshmuar që kuvendi e ka forcën më të madhe dhe Komisioni në atë rast do të mund të ketë karakter hulumtues, pra një organ që do të mund të kërkonte dokumente nga ushtria, nga policia dhe dokumente që neve si organizata jo qeveritare nuk kemi qasje. Ne jemi shumë të guximshëm. Prej nesh pritet durim dhe një punë këmbëngulëse afatgjate. Është vështirë të thuhet se sa do të zgjasë ky proces, por unë mendoj se do t'ia dalim në krye. Po ashtu, kur ta themelojnë parlamentet, do të bëhen organe zyrtare të vendeve të ish-Jugosllavisë dhe flasim për strukturën e tyre të KOMRES. Kemi një konsensus që komisionet do të duhej të kenë zyra në rajone në të cilat kanë pasur pësime të veçanta gjatë luftës. Pra, një zyre rajonale dhe nacionale dhe që do të jenë përgjegjëse në nivel të KOMRES. Mendoj se nuk është aq me rëndësi struktura sa vetë përbërja e njerëzve. Ajo që e tha kolegu, duhet të jenë këta njerëz dhe është një debat me rëndësi dhe të them, mua shpesh më dhemb koka kur flasim për atë se si do të zgjedhën njerëzit përkatësisht komisarët e këtyre komisioneve, që janë njerëz kyç. Këta do të duhej të ishin njerëz të ndershëm, me prestigj intelektual, që kanë një karrierë dhe të kaluar të pastër, njerëz përgjegjës për të ardhmen e këtyre njerëzve dhe vendeve. Mendoj se të tillë ka në mesin tonë dhe në secilin vend rajonal. Mos ta harrojmë atë dimensionin rajonal. Pra, si do t'i zgjedhim njerëzit në Kroaci të pranohen edhe në Kosovë dhe si njerëzit nga Kosova të pranohen në Serbi. Pra kur të vijmë në këtë pikë, mendoj se edhe mund t'i marrim edhe mendimet tuaja për këtë temë dhe mendoj se kjo është një çështje dhe temë me rëndësi. Pra,

tash them se ky është një organizëm që bëhet në bazë të përvojave të viktimave por të gjithë ata që janë në koalicion me KOMREN këtë e dinë sepse kjo është çështje më e rëndësishme. Tashmë, ne kemi përfunduar. Nuk është ky një organ gjyqësor, nuk do të marrë vendime. Komisioni nuk është për të marrë aktgjykime por bën dëgjimin e viktimave, i dokumenton faktet e të gjitha atyre që kanë ndodhur dhe në njëfarë mënyre t'i shkruajë rekomandimet dhe nëse ngritën qendra memoriale aty bëhen reforma brenda shoqërisë, por nuk është një organ i ndjekjes. Pra, nuk do t'i ndëshkojë ata që eventualisht do të jenë përgjegjës për krime të bëra të luftës por mund t'i emërojë dhe mund t'i kërkojë përgjegjësinë morale dhe këtë mund ta bëjë, përveç nëse viktimat nuk e falin dhe ne mund të kemi mendoj një funksion të dyfishtë në këtë aspekt. Unë mendoj se me këtë mund ta përfundoj. Mendoj se kam hapur një hapësirë të mjaftueshme dhe e kemi pasqyruar atë Komisionin tonë që është në të gjitha vendet. Kemi qendrat ku janë komisarët, të cilët i kemi zgjedhur dhe ajo që harrova të them, është se mendoj që në Prishtinë është hapur dhe këtë e them së fundi, pra koha kur do të përqendrohet Komisioni. Mendoj se flitet për vitin 1991-2001 për këtë periudhë kohore. Unë e di që në Kosovë thonë se për këtë nuk ka qasje dhe nuk është ajo suazë kohore për të cilën ju angazhoheni dhe mendoj se për këtë mund të flitet. Unë me këtë do ta përfundoj dhe ju falënderoj.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit Suzana! Besoj se Suzana tash hapi edhe një kuti, ndoshta kuti tjetër të Pandorës me plotë pyetje që juve kanë me ju duktë që ju ka shtyrë të bëni pyetje. Dua ta konfirmoj këtë që tha në lidhje me rekomandimet e këtij komisioni, raporti final, po qe se vjen deri te formimi i këtij komisioni, raporti final që ky komision i pavarur do të dalë, do të dalë me rekomandime dhe po qe se në atë raport dalin rekomandime që, po e marr si shembull, rastin e Kosovës, Qeveria e Serbisë akuzohet ose kreu politik për këtë, këtë e këtë, atëherë do të obligohet edhe kjo Qeveri e Serbisë së tanishme që të merret me dëmshpërblimet e viktimave ose varet se çka do të përcaktohet në mandat. Ne mundemi si shoqëri civile me propozuar një mandat, mirëpo kjo prapë shkon në nivelin më të lartë dhe ata vendosin. Suzana e përmendi që, meqë ka gra të dhunuara në të gjitha vendet, që kanë qenë të prekura me konflikt dhe se është e drejtë e patjetërsueshme që shkelja e të drejtave të grave dhe dhunimet të jenë si mjete më të vrazhdët ose mënyrat më të vrazhdët në luftëra që kanë ndodhur. Veç të përmendim edhe këtë. Kjo pra hyn në mandat, por edhe koha se sa do të punojë komisioni, pastaj se cilat shkelje të të drejtave të njeriut do të përmblihen. Ne mundemi, nisur prej përvojave që i kemi, të vendosim për shembull si shoqëri civile në konsultime me ju do të bëjë një listë me të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut, konkretisht, që kanë ndodhur në Kosovë. Mirëpo, mos të harrojmë se mandati ose komisionet e kanë kohën e caktuar të punës dhe se numri i personave të cilët do të punojnë do të jetë i kufizuar dhe komponentën kryesore se sa do të kushtojë krejt puna e këtij komisioni, financat janë komponentë që ne nuk mundemi me i anashkaluar, duke marrë parasysh se si qëndrojnë ato në rajon. Ne nuk jemi shtet i pasur, por edhe as disa vende tjera. Zakonisht pritet që në këto komisione, sidomos Komisioni, për shembull në Afrikën e Jugut financohen prej bashkësisë ndërkombëtare ose UN. E tash, e keni parasysh kur ti financohesh prej dikujt dhe se këtë ju e dini shumë mirë që punoni me organizata të huaja. Do me thënë ka shumë modalitete, ka shumë pengesa, ndoshta jo edhe aq shumë pengesa por ka shumë probleme të cilat duhet të diskutohen dhe edhe ne t'i diskutojmë para se të vijmë deri te formimi ose deri te propozimi për një komision eventual dhe ai propozim t'i dorëzohet qeverive. Unë mendoj se mund të shkojmë ta shohim filmin, e pastaj të diskutojmë lidhur me këtë.

**Gazmir Raci:** Veç, pasi jam këtu, me iu dhënë përvoja edhe të tjerëve, desha edhe diçka sa i përket periudhës së punës së komisioneve. Zakonisht prej komisioneve që i kemi përmend më herët, thuhet se periudha kohore duhet të caktohet definitivisht. Preferohet, në përgjithësi, sipas komisioneve të kaluara, 1 deri në 3 vite. Pse 1 deri në 3 vite? Sepse, në qoftë se shkon më shumë se 3 vite atëherë çështja e fakteve mund të relativizohet shumë. Pastaj, këtu është edhe çështja e financave që e përmendi Nora, është problem, nëse është më shumë se 3 vjet dhe bëhet pyetje sa ka mundësi shteti ose shtetet me mbajt atë mbi supet e veta. Për shembull, Komisioni kombëtar për zhdukje në Argjentinë, ka punuar vetëm 9 muaj. Komisioni i së vërtetës në Afrikën Jugore – Siera Leone, Peru ka punuar 2 vite. Komisioni në Timorin Lindor për pranim dhe pajtim 3 vite. Komisioni në Marok ka punuar 2 vite, si dhe Komisioni në Guatemalë ka punuar 8 muaj. Këto janë vetëm disa shembuj që desha t'ua tregoj.

**Shukrije Gashi:** Vetëm në shifra, me i dhënë për afërsisht se sa do të kushtojë ndoshta 2 vjet punë, e të themi se nëse komisioni përbëhet prej 3 deri 15 vetë, varet prej natyrës, mund të kushtojë deri 6 apo 7 milionë dollarë. Tash, ai komisionar, paramendoni se çfarë pune ka dhe çfarë përkushtimi duhet me i dhënë punës.

Pastaj, përveç financave, janë edhe disa çështje të personave me trauma. Mos të harrojmë se puna duhet të jetë shumë intensive dhe viktimat të cilat do të vendosin të dëshmojnë para publikut, me ato viktimat do të punojnë ekipet e konsulentëve, të psikologëve me muaj të tërë ngase atyre iu nevojitet parapërgatitje që të jenë më të fortë për t'ua ballafaquar edhe me kriminelin, mirëpo edhe me publikun, që të jetë dhe të shërbejë ajo dëshmia e tyre edhe për të ardhmen. Do me thënë është proces shumë më i komplikuar se që duket në fillim.

**Veprorë Shehu:** Me thënë, të vërtetën, nuk po di kah me ia nis. Kam dy pyetje, e një numër të rekomandimeve, që dalin prej përvojës sonë të punës me këto viktimat, por edhe me gratë – me të zhdukur që kemi si grup përfitues. Pyetja e parë ka të bëjë me definimin e dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit dhe krim lufte. Ne kemi qenë si organizatë pjesë e peticionit dërguar drejtpërdrejt Prokurorit të Gjykatës së Hagës, zotit Bramec lidhur me rastin e Karaxhiqit. I kemi dërguar një letër, ku kemi kërkuar që dhuna seksuale jo vetëm që nuk mjafton të trajtohet si krim lufte por në aktakuzë të përfshihet si akuzë e veçantë. Sepse, unë e di që në kuadër të akuzave tjera është e përfshirë edhe dhuna seksuale. Nuk e di, por po e pyes Suzanën: A është arritur kjo a jo. Unë me informatat që kam prej partnereve tona nga Gjermania, që bëjnë monitorimin e proceseve në Gjykatën e Hagës, e kemi pasur një dëshmitare ne vetë, që ka dëshmuar për dhunën seksuale, për momentin e kanë alokuar në Suedi për shkak të rrethanave këtu jo të favorshme për të. Dhe, po më intereson a është akoma aty apo është vetëm pjesë e aktakuzës së përgjithshme. Kjo nën një. E dyta, për mandatin e Komisionit. A do ta ketë Komisioni mandat, sepse mendoj që i paraprinë të gjitha proceseve tjera që të sqarohet kjo. A do ta ketë Komisioni mandat vlerësimin e llojit të konfliktit apo luftës – a ka qenë gjenocid, spastrim etnik. Shumë ka huti rreth kësaj dhe unë kam pas vetë personalisht edhe konflikte me ndërkombëtarë, kur ata e quanin luftën e Kosovës thjeshtë konflikt të armatosur. Vetë definimi i kësaj forme të luftës, të konfliktit, të jep ty të drejtë të kërkosh edhe kompensim.

Në qoftë se është konflikt, s'ka kompensim. Harroje kompensimin, s'ke se pse të formosh komisione. Ajo duhet të cilësohet luftë dhe atë me tendencë të gjenocidit e të spastrimit etnik, e krejt. A e ka Komisioni këtë mandat që t'i rekomandojë Qeverisë ta cilësojë si të tillë? Ndoshta ky është edhe një kontest që duhet të përfshihet edhe në gjykatat ndërkombëtare. Tash e kemi edhe një kontest në Gjykatë rreth vlerësimit të statusit të Kosovës, por si do qoftë është diçka që duhet me menduar. E para. E dyta. Para se me filluar çdo gjë për komisione, është mirë që si koalicion, ndoshta edhe në fazën e formimit të komisioneve t'ua kërkohet shteteve që kanë

gjeneruar lufta, në këtë rast Serbia dhe kanë kryer krime, së pari të kërkojnë falje publikisht. Është shumë me rëndësi për viktimat që të futen në procesin e dëgjimit publik edhe krejt çka përfshihet në komisione në qoftë se dihet bile se është kërkuar falje publikisht. Ne e kemi përvojën me “Gratë në të zeza”. Kemi bashkëpunim si koalicion dhe punojmë për ndërtimin e paqes me Rrjetin e grave të Kosovës, është formuar ky koalicion. Prej nesh, disa kemi qenë viktimat të drejtpërdrejta, unë e kam humbur vëllanë gjatë luftës, do të thotë edhe unë jam e prekur drejtpërdrejtë dhe për ne ka qenë shumë e rëndësishme kërkimi i faljes që kanë bërë ata publikisht edhe para nesh, edhe publikisht para medieeve, kanë ndikuar pozitivisht te nëna ime, kanë ndikuar pozitivisht te shumë viktimat, me të cilat ne punojmë drejtpërdrejt dhe kanë ndikuar që të krijohet një pajtim në mes veti, ndoshta një miqësi shumë e madhe. Mendoj që është e rëndësishme kjo, para se të fillohet me çdo gjë tjetër. Dhe, desha edhe disa rekomandime t’i jap. E para, meqë jemi të specializuar si organizatë me punën me trauma, sidomos me traumat e dhunës seksuale. Ne, që dhjetë vite, kemi arritur një 10% të grave që i përkrahim ne me i shpales rreth dhunës seksuale. Është një proces shumë i gjatë që ndoshta një deri tri vite nuk do të mjaftojnë. Po flas vetëm për këtë kategori të grave. E dyta. Anëtarët që do të përzgjidhen për të udhëhequr këtë komision, duhet të kenë njohuri shumë të mëdha dhe mos të them të jenë psikolog se nuk mjafton as psikolog me qenë, por të kenë njohuri, të paktën, pak më të avancuar rreth traumës posaçërisht traumës së dhunës seksuale gjatë luftës. Sepse, vetë procesi i dëgjimit, vetë procesi i qasje së këtyre viktimave është shumë me rëndësi. Në qoftë se Komisioni nuk e di çfarë janë simptomat e ri-traumatizimit, çka është disocimi, çka janë deklaratat kontradiktore që shumë shpesh ndodhin në mesin e viktimave për shkak të traumës, ai komision nuk ka me dit me udhëheq punën e vet. Kjo është shumë e rëndësishme. Do të thotë, të marrin trajnime, edhe në qoftë se nuk kanë trajnime bazike të marrin trajnime paraprakisht rreth traumës, posaçërisht në fushën e dhunës seksuale gjatë luftës. Pastaj, diçka tjetër që desha të rekomandoj. Normalisht më parë rekomandova për legjislacionin dhe futjen e këtyre grave që të trajtohen si viktimat civile të luftës, gjë që e ka bërë edhe Bosnja edhe pse Bosnjës i ka ndihmuar shumë marrja e çmimit të “Ariu i artë” në Berlin, film i cili e ka dhënë tamam situatën dhe e ka përshkruar situatën e këtyre femrave. Është një kategori edhe më tabu se sa ato që kanë përjetuar dhunë seksuale. Janë gratë që kanë lind fëmijë si rezultat i kësaj dhune. Ne e kemi pas një rast. Ka shumë raste, por unë e di çfarë është ajo si traumë dhe sa kemi restriksione në aspektin social e kulturor rreth kësaj teme. Domethënë, është dy herë më tabu. Desha diçka edhe për çështjen e grave me të zhdukur. Ne si Organizatë, kemi pas mjaft probleme për përkrahje ligjore të femrave me të zhdukur. Shtrohet pyetja, pse? Për shkak të traditës sonë, të kontekstit tonë kulturor, marrëdhëniet me familjen e burrit. Dhe, ka qenë shumë vështirë, se për me marrë disa beneficione, disa asistencë sociale, disa ndihma – gratë nuk kanë mund t’i deklarojnë bashkëshortët si të vdekur. Sepse, trupat nuk iu kanë kthyer dhe iniciativa e tyre që me deklaruar bashkëshortët për të vdekur është marrë për të keq, është keqinterpretuar nga ana e familjeve të tyre dhe ato kanë hezituuar në këtë drejtim.

Ne e kemi sektorin juridik, kemi bërë diçka me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar për t’ua lehtësuar atyre qasjen në këto të drejta ligjore të tyre pa pas nevojë, thjeshtë, pa iu ardhur trupat, pa u identifikuar kufomat, pa u bërë riatdhesimi i tyre, pa pas nevojë me i prituri këto procedura që ato që kenë qasje në të drejtat e tyre juridike. Duhet pasur disa lehtësime. Disa janë bërë, por nuk janë të mjaftueshme. Dhe mendoj se kjo në legjislacion duhet të ketë njëfarë efekti. Ndoshta edhe kjo bëhet përmes këtyre komisioneve. Edhe diçka desha të them. Unë, vërtet jam e brengosur rreth procesit të dëgjimit publik të viktimave të dhunës seksuale. E kemi pas një rast, që e përmenda pak më herët, e cila ka folur pak më haptas, ka folur para organeve të

UNMIK-ut, ka folur para Nikoll Kidmanit, që ka qenë si ambasadore e vullnetit të mirë në kuadër të UNIFEM-it te ne, por megjithatë ka folur vetëm me këshilluesin e saj, edhe pse e ka ditur që ne anëtarët tjerë të stafit jemi në ngjarje. Dhe, nuk është aq lehtë, aq më tepër para një Komisioni me folur ose edhe para disa tjerëve, jashtë Komisionit, varësisht si do të strukturohet ky proces. Sa do të jenë të ligjshme dëshmitë e organizatave joqeveritare, në këtë rast edhe të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dokumentet e arkivuara, po edhe ato që mblidhen më vonë për këtë Komision dhe a është vetëm dëgjimi publik i vetmi instrument i mbljedhjes së fakteve apo ka mundësi të mblidhen faktet edhe ndryshe.

Ndoshta shumë u hapa. Ju falënderoj për durimin!

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit, Veprorë! Unë besoj se për të gjitha këto shqetësime dhe brenga të të gjithë neve do të ketë hapësirë dhe ka hapësirë në Komision. Janë çështje të cilat do të adresohen. Nuk duhet harruar një fakt, se për shkak të caktimit kohor të veprimit të Komisionit në asnjë rast, të gjitha komisionet që kanë vepruar deri më tash, nuk është arritur që të mbulohet çdo gjë për arsye se mbetet te shoqëritë e ndryshme që të përcaktojnë cilat janë çështjet kryesore në të cilat ata dëshirojnë të përqendrohen, duke i përfshirë edhe të tjerat. Mirëpo, janë edhe një sërë çështjesh në të cilat, në mënyrë primare, duhet përcaktimi pastaj edhe të mbetet mundësi për të tjerat. Këto që i përmende, të gjitha bien në fokusin e çështjeve kryesore. Kujtoj, për arsye se edhe ka hapësirë më shumë. Do të thotë, mbetet te ne shoqëritë në ish-Jugosllavi se në cilat çështje do të dëshirojmë të përqendrohemi, janë ato çështje që më së shumti e kanë goditur të gjithë shoqërinë tonë dhe ato do të jenë çështjet kryesore.

Tash, unë konsideroj është koha që ta shohim këtë filmin...

**Suzana Kunac:** Pyetja që e parashtroi kolegja, mendoj se është shumë më rëndësi dhe pikërisht flet për problemin tonë. Pra, pyetja e juaj, nëse ka pasur aktakuzë të veçantë për dhunim, unë nuk kam përgjigje, nuk kam as njohuri për në Kroaci. Natyrisht, vetëm se është përcjell procesi dhe në këtë nivel ka mbetur. Kjo na motivon të gjithë neve ta dimë përgjigjen në këtë pyetje. Pra, faleminderit edhe një herë. Pyetja tjetër, mendoj se është me rëndësi dhe mendoj se dikush nga Fondi për të Drejtën Humanitare mund të na ndihmojë në përgjigje, nëse pra komisioni në mandat do të mund të përcaktohet si motivim të spastrimit etnik dhe mendoj që Komisioni në raport me të gjitha njohurit duhet t'i përkufizojë dhe definojë çështjet para se të fillojë punën dhe pajtohem me këtë aspekt. Pra, mendoj se kjo është një pyetje shumë me rëndësi dhe nuk është ky një konflikt në mes të dy fshatrave të zënë në mes veti, siç tenton nganjëherë këto konflikte t'i interpretojë bashkësia ndërkombëtare. Kjo që tha Shukria, se Komisioni duhet të ketë ekspertë që duhet të merren pikërisht me qasjen ndaj viktimave dhe nëse dhunimi hyn si krim, mendoj se do të duhej të sigurohet edhe mënyra e qasjes në raport me këto viktima që janë pak më ndryshe se të tjerat, ndonëse mendoj se ka edhe ngjashmëri shumë të mëdha në mes të vetë viktimave. Po ashtu, keni parashtruar pyetje dhe mendoj se një prej roleve të rëndësishme të Komisionit është se duhet të përgjigjet në raport me nevojat e viktimave. Pastaj, anëtarët e familjeve kanë bërë një interpretim të gabueshëm në raport me viktimat, përkatësisht me gratë që kanë mbetur tani, duke pasur parasysh kontekstin kulturor. Kjo nuk mund të ndryshohet përmes mandatit të Komisionit por kam gjetur një shembull dhe këtë e kanë bërë disa komisione, si Sri Lanka, Argjentina dhe kanë tentuar ta zgjidhin këtë problem ashtu që të zhdukurit janë trajtuar si ... dhe kanë tentuar që të drejtat qytetare të zgjidhen pa u shpallur i vdekur personi në fjalë. Pra, kjo është ajo që unë e shoh këtu dhe mendoj se mund të gjendet një mënyrë që do t'i përgjigjet edhe kodit kulturor të shoqërisë e mos ta ketë një ngarkim sërish.

**Nerimane Gërguri:** Desha të kyçem në këtë pyetjen e rastit të grave me anëtarë të zhdukur të familjes, në këtë rast të bashkëshortit.

Sa e di unë, të paktën në ish ligjet e Jugosllavisë, ka qenë një nen i cili parasheh një kohë të caktuar nëse një person është i zhdukur dhe nuk gjendet për një kohë të caktuar, atëherë automatikisht ai person merret si person i vdekur dhe në anën tjetër, unë jam thirrur në atë ligj për nxjerrjen e dokumenteve që mu kanë nevojitur dhe në ndërkohë do të thotë jam thirrur në atë nen dhe e kam përfituar nxjerrjen e dokumenteve që mu kanë nevojitur. Do të thotë, ta shikojmë edhe atë anën ligjore, çka parasheh ligji, qoftë ai i përparshmi apo ky i tanishmi.

**(Ndërhyrje – pyetje)**

“Gjashtë vjet e gjysmë”, veç, në thonjëza. Dhe po më vjen keq ta cek se ka kaluar një kohë shumë e gjatë e ende nuk është ndërmarrë asgjë në këtë aspekt, çka është duke ndodhur me këtë grup të grave.

Kisha dashur ta përshëndes zonjën nga Kroacia Suzana Kunac dhe shpreh keqardhjen pse nuk kanë ardhur edhe përfaqësuesit e rajoneve tjera, të vendeve tjera.

Po kisha dashur edhe të bëj një pyetje shtesë, meqë mu dha fjala, për Suzanën. Sa e di unë, ka qenë një iniciativë prej anës së Kroacisë që me kërkuar prej anës së Serbisë, nga Qeveria e Serbisë që ajo të kërkojë falje ndaj Kroacisë për të gjitha krimet e bëra. Kjo është në njëfarë mënyre, thikë me dy teha, si themi ne në popull, sepse vetë fakti se ti po kërkon falje, në njëfarë mënyre po pranon përgjegjësinë dhe duhesh ta krijosh një lloj dëmshpërblimi për këto viktima. A është arritur kjo dhe çfarë është situata tani në Kroaci? E bëj kështu, për atë që në njëfarë mënyre të kemi edhe ne një model se si të veprojmë më tej.

**Suzana Kunac:** Unë besoj se asgjë formalisht nuk është bërë. Mendoj se është bërë njëfarë këmbim fjalësh dhe e di që këtë e ka bërë në Knin Boris Tadiqi dhe edhe Mesiqi me një rast e ka bërë, por asgjë më tutje nuk është formalizuar. Aq sa jam unë e njoftuar, mendoj se kjo çështje meriton një vëmendje më të madhe dhe hulumtim, e unë nuk jam aq eksperte për këtë, por ajo që më duket mua mund të ndodhë dhe ka të bëjë me dëmshpërblimin, është kjo çështje e Komisionit dhe deri më tani praktikat kanë treguar në disa vende që kryetarët në momentin e raporteve përfundimtare të Komisionit kanë parë të arsyeshme të kërkojnë falje. Pra, vetëm atëherë dhe në atë moment sikur ka filluar një histori e re dhe mendoj se edhe kjo paraqet një komponentë dhe rol të rëndësishëm të Komisionit. Prandaj çështja e kërkim faljes dhe e dëmshpërblimit, jo të atyre që janë përgjegjës ndoshta të drejtpërdrejtë për krimet e bëra në luftë por ata që do të vazhdojnë një politikë të re apo të tjerë, kjo iu përket dhe disa kryetarë pikërisht kështu kanë vepruar.

Nuk e di se a ju kam dhënë përgjigje të saktë në raport me Kroacinë, por ka mbetur në nivel të vullnetit të mirë me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve të mira fqinjësore, dhe asgjë s’është bërë më shumë.

**Sakibe Doli:** Do me thënë, është shumë me rëndësi në mandat të Komisionit që ata të merren me listën e përgjegjësve, ata të cilët kanë shkaktuar gjithë këtë tragjedi në këtë rajon? Do me thënë, në Gjakovë dihet për viktimizimin e tërë një qyteti, duke filluar nga baza ekonomike deri në marrjen e jetëve. Jo gjithë herë, viktima ka qenë në dijeni, do me thënë kush është kryerës i veprës. Ata kanë ardhur të maskuar. Ata e kanë ndryshuar zërin. Në asnjë moment ne nuk kemi mund ta identifikojmë kush është. Mirëpo, do të thotë, përgjegjësi që i ka detyruar ata dihet. Për shembull, në Gjakovë, në atë modën e të kthyerve ka ardhur i pari komandanti i shtabit të luftës dhe tani ish administratori i asaj kohe, i qytetit, që tash s’po më kujtohet emri, ka kërkuar pajtim. Na ka thirrur shoqërinë civile dhe ne me përkrahur atë person sepse gratë e Shoqatës që kanë të zhdukur, do të thotë, kanë reaguar. Dhe tani ai ka kërkuar nga ne pajtim. Si



të lypim ne pajtim, thoshte a ke fakte. Qysh ti ke me gjet faktin kur nënës ia ka nda burrin, ai ka ardhur i maskuar dhe e ka vra pak pas shtëpisë. Ai thoshte, a keni fakte. Përderisa ka qëndruar në krye të shtabit, përgjegjësia bie mbi të. Ai mund ta dijë kë e ka urdhëruar për ta kryer atë veprim. Dhe unë mendoj se është një rekomandim që në mandat të Komisionit të futen edhe njerëzit përgjegjës, që i kanë shkaktuar krimet. Pikërisht, kjo çështje është përmendur disa herë dhe pikërisht qendrat komanduese, do të thotë qendrat prej nga janë marrë urdhrat për kryerjen e krimeve do të futen në mandat. Një çështje shumë me rëndësi, e cila do t'i kontribuonte pikërisht kësaj çështjeje do të ishte që viktimat, të cilat ende janë gjallë dhe kanë një moshë të shtyrë, sa më shpejt të ndërmerrenin veprime të tilla, do të thotë të dëshmimit për faktin se një ditë do të ndodhë vdekja dhe argumentet e faktet do të mbesin në heshtje. Ju e thatë shumë mirë që ish administratori i Gjakovës, nga përfaqësia ndërkombëtare, ka kërkuar që ajo të verifikohet, të vërtetohet, të dëshmohet. Qysh do të mund të dëshmohet një rast i tillë në qoftë se personi i cili drejtpërsëdrejti ka qenë i atakuar ose anëtar i familjes nuk do të jetë gjallë. Prandaj, proceset e tilla kërkojnë veprime të shpejta. Do të thotë, ky do të jetë veprimi më i ngutshëm i nevojshëm që duhet të bëhet.

Shoqëria civile, shoqatat e të zhdukurve, të viktimave, të veteranëve e të tjerë, të gjithë kanë bërë shumë mirëpo të gjitha këto argumente duhet menjëherë të strukturohen dhe të futen në proces, sepse, përndryshe, nuk e di se si do të arrijmë që të dëshmojmë. Kaq.

**Nora Ahmetaj:** Sakibe, do të kërkohej komanda apo zinxhiri komandues për mungesën e fakteve, ose mbledhjen e fakteve. Por për një rast, nuk do të mblidhet vetëm një fakt apo një dëshmi, do të mblidhen shumë dëshmi në mënyrë që të verifikohen. Në momentin kur zinxhiri komandues zbulohet ose patjetër do të dihen, sepse nëse ne vetëm i parashohim mandat se cilat janë mënyrat e ushtrimit të dhunës dhe aty hyn, për shembull, masakrimi ose përdhunimi, ajo është se ka shkuar me komandë urdhëruese dhe atëherë dihet se kush nga kreu i Serbisë dhe mund të futet si element tjetër, për shembull me u akuzuar qeveria e mëparshme e Serbisë dhe ajo pastaj ka me i mbajt reperkusionet ose mënyrën se si duhet paguar dëmshpërblimet. Ose, në raste konkrete, mos ta marrim vetëm Serbinë por mund të jetë cilido, se këtu është në pyetje agresori dhe viktimat. Tjetër është kur e përmendi edhe Veprorja te mandati i dhunës dhe kërkimi i faljeve. Kjo patjetër duhet me hy dhe hyn nga se viktimat dhe shoqëria civile kur e përgatit për shembull formatin e atij komisioni i fut krejt ato rekomandimet tuaja, pra përveç kërkimit të faljeve. Ka shumë shtete, dhe tash do ta shohim filmin për Perunë, kur bash kryetari i Perusë Toledo ka kërkuar falje për viktimat dhe e ka bartë përgjegjësinë në emër të Qeverisë që në njëfarë mënyre me i shpague ato dëme ndaj familjarëve të viktimave. Pastaj kemi edhe raste, nëse futet gjenocidi dhe spastrimi etnik. Kjo do të vërtetohet në bazë të ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare pastaj në bazë të fakteve nga terreni se çka nënkuptojmë gjenocid dhe çka nënkuptojmë spastrim etnik dhe këto janë terme shumë të ndjeshme që duhet punuar me ekspertë shumë të lartë.

Nejse, të mos marrim tash kohë, ta shohim filmin dhe pastaj të vazhdojmë diskutimet edhe për pyetje tjera.

**(Shikohet filmi dokumentar)**

**Eli Krasniqi:** Sa herë i kam shikuar këta filma dhe sa herë kemi diskutuar për një komision potencial të gjetjes së fakteve dhe të vërtetës dhe sa herë kam menduar për këto dëgjimet publike, duke qenë se janë shumë të forta emocionalisht dhe duke qenë se janë shumë të një ballafaqimi me të kaluarën, që është shumë traumatike, gjithmonë më ka shkuar në mendje një gjë, se cila është nevoja për të organizuar njëfarë mbështetje psikologjike gati të secilit individ. Natyrisht, nuk e kam menduar se kishte me mund të bëhet ajo.

Në anën tjetër, krejt kjo, nëse nuk menaxhohet mirë, a kishte me qenë njëfarë lloji i katarzës që pastaj kishte me shkaktuar tensione edhe më të mëdha. Po mendoj se ne duhet të mendojmë shumë për të angazhuar ekspertë të fushave të ndryshme dhe ndoshta pikërisht të jenë ata persona – komisionarë të cilët e kanë atë kredibilitetin në shoqëri që kjo katarzë të mos eskalojë në konfliktuozë dhe tensione. Sepse, duke i dëgjuar ato dëshmi, është shumë vështirë të mos krijohet edhe më shumë njëfarë ndjenje e urrejtjes dhe hakmarrjes.

Natyrisht, nuk kam menduar për format qysh do të ishin bërë ato, por gjithsesi kam menduar që ajo mos po shkakton ndonjë farë situatë më të tensionuar dhe më konfliktuozë nëse nuk mendohet mirë, nëse nuk angazhohen ekspertë të cilët kishin mund të ndihmojnë në organizimin e kësaj.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit Eli! Ky është një shqetësim pra normal. Mirëpo, gjithmonë duhet të kihet parasysh se këto çështje zhvillohen në bazë të përvojave të të tjerëve. Tash, varësisht prej rrethanave, të peshës së pësimeve do të organizohen edhe komisione të tilla. Natyrisht, kjo në radhë të parë ka të bëjë shumë edhe me angazhimin e ekspertëve. Kur themi ekspertë, duhet pasur parasysh kompleksitetin e një personaliteti të tillë, i cili ngërthen gjithçka në vete. Do me thënë, nga aspekti profesional i çështjes, i paanshmërisë, objektivitetit dhe të qenurit person stabil. Kur e them stabil, është në kuptimin e shfaqjes së mirëkuptimit për të gjitha rastet që do të parashihen të jenë pjesë e trajtimit, por duke mos u lëshuar ose dhënë shumë ndjeshmërisë, me qëllim që të shmangët mundësia e animit. Do me thënë, në këtë rrafsh është parashikuar ose parashihet se do të jetë një formim ose përbërje e komisionarëve të tillë.

Natyrisht se sa do të jetë i suksesshëm ose nuk do të jetë i suksesshëm një komision i tillë, varet krejtësisht nga azhuriteti, angazhimi e përkrahja dhe se sa do të jetë e fuqishme përkrahja dhe interesimi i shoqërisë civile dhe presioni i shoqërisë civile, që përzgjedhja të jetë objektive nga qeveritë e shteteve respektive. Kjo do të thotë, është një mundësi. Kurse mua personalisht më bëri përshtypje pamja e mëhershme, do të thotë në fillim të këtij dokumentari dhe ma përkujtoj rastin e grave të Krushës që ishte po ashtu një rast shumë i ndjeshëm kur reagimi i tyre ndaj atyre që kishin kryer akte të dhunshme ndaj këtyre grave në momentin kur i panë ato që u kthyen në Krushë dhe bënë përpjekje që të ndalonin hyrjen e tyre, policia e atëhershme e UNMIK-ut ndërmoi një veprim që ishte antinjerëzor dhe në fakt qeveria e atëhershme nuk bëri kushedi se çfarë për ta vënë në dinjitet reagimin e atyre grave. Kjo ishte, pra, një ngjashmëri me qeverinë, me veprimin e qeverisë në dokumentarin që e pamë më herët. Pse e mora si shembull këtë? Sepse, këto procese janë të ndjeshme. Janë shumë të ndjeshme dhe shumë të dhembshme. Prandaj, këtyre proceseve duhet t'iu qasemi edhe me ndjeshmëri por edhe me stabilitet. Se, duke e tepruar me ndjeshmëri, kam frikë se në vend që të vihet drejtësia në vend dhe të mos harrohen kryerësit e veprave penale, ne mund t'i bëjmë dëm procesit duke vajtuar. Vajtimi, është pjesë e procesit! Është e ndjeshme, mirëpo duhet të jemi azhur me kohën. Të jemi efektivë dhe të përpiqemi që ta zëmë kohën, të mos na ikë koha dhe kryerësit e veprave penale të mos mbesin pa u dënuar dhe njëherit, edhe dëshmitarët potencialë, ta kenë mundësinë që të dëshmojnë dhe mos të marrin me vete dëshmitë bashkë me vdekjen. Kjo është shumë e rëndësishme. Ju, e pata edhe vetë. Për shembull, edhe gjatë procesit të punës së komisionit që, jo gjithmonë, merren parasysh të gjitha rastet, trajtohen me të njëjtin përqendrim. Në krejt azhuritetin e punës së Komisionit lojtarët kryesorë ose bartësit kryesorë janë, përsëri po e them, insistimet e shoqërisë civile se a do të jenë apo s'do të jenë të suksesshme këto procese. Më duhet të them se, më vjen keq, pse sot këtu mungojnë kaq shumë përfaqësues dhe nuk është asnjë nga shoqëria civile e komunitetit serb dhe e komuniteteve të tjera. Pra, është fatkeqësi e madhe. sepse, këtu janë të pranishme pjesa

dërmuese e grave të shoqërisë civile, që e dinë se kur është mbajtur mbledhja e fundit e Rrjetit të grave, të gjitha gratë, edhe përfaqësueset e komunitetit serb u deklaruan fuqishëm se janë të interesuara që të marrin pjesë, bile edhe e kanë vërtetuar, e kanë konfirmuar pjesëmarrjen, dhe nuk janë këtu. Prandaj, ne jemi ato të cilat, në mbledhjet e ardhshme të Rrjetit të grave duhet t'i shtrojmë këto çështje. Bile, është fatkeqësi e madhe po ashtu që mediat nuk janë të pranishme sot këtu, të cilat çdo herë i kemi thirrur.

**(Reagim – nuk dëgjohet për transkribim)**

**Belxhyzare Muharremi:** Nuk desha të të ndërpres, por tërë kohën mendoja dhe e pyetja vetveten a do të ju dërgohet medieje një komunikatë lidhur me atë se për çka është biseduar dhe për çfarë është mbajtur ky takim shumë i rëndësishëm, në mënyrë që edhe opinioni i gjerë ta di për çështjet të cilat janë diskutuar këtu.

**Shukrije Gashi:** Është vërejtje dhe sugjerim me vend, po e them, sugjerim me vend. Ka ndodhur herëve të tjera që janë dërguar komunikatat për shtyp dhe nuk janë publikuar. Domethënë, edhe një herë po e them që ne si shoqëri civile nuk duhet t'i heshtim rastet e tilla dhe këto të mos na përsëriten. Nuk duhet të bimë pre e lojërave të përkrahjeve të ndryshme politike, interesave të ndryshme, ose të them lojërave të dëmshme me të cilat përpiqen t'i minojnë proceset e tilla. Ne duhet gjithmonë të kemi parasysh se faktorë përqendruar në këtë çështje janë vetë viktimat. Prandaj, nuk duhet që në kurrizin e viktimave të luajmë lojëra të tilla që edhe më tutje të mbeten viktimat të pa emra, të heshtura, të zbrapsen proceset, të zvarriten e të mos bëhet asgjë. Faleminderit! Urdhëroni, për pyetje! Kush ka komente, pyetje?

**Eli Krasniqi:** Mendova më herët se, nëse kishte qenë e mundshme, ose a ia kishte vlej të që rekomandimet tjera, gratë të cilat nuk kanë folur sot, për çka e di se kanë shumë gjëra t'i thonë, me i çua me E-mail Rrjetit të grupit të grave dhe pastaj Rrjeti me ua forwarduar juve dhe kështu me bërë njëfarë komunikimi. Këtë e them për shkak se, po më duket, ka shumë arsye ose faktorë pse dikush nuk po mundet, ose nuk do ose për çfarëdo arsye me u kyç në diskutim. Pastaj, çështje tjetër është se, pas këtij konsultimi – çka? Kështu që mua, shpeshherë më ndodh, duke shkuar në shtëpi, më bie në mend diçka. Prandaj, të paktën, sa i përket grave, sa i përket këtij konsultimi, të jetë një adresë e E-mailit ku ju mundeni me i adresuar disa gjëra. Edhe pse, dorën në zemër, po më duket...

**Nora Ahmetaj:** Eli, vetëm pak! Në rregull, nëse gratë hezitojnë, por mua po më duket pak si absurde, secili e ka të drejtën të flas dhe është ajo e drejtë e secilit individ me thënë mendimin e vet. Nën një.

Dhe, nën dy. Ato nëse i adresojnë dhe donë me i adresuar pyetjet, e kanë adresën, i adresojnë edhe këtu te “Partners Kosova” dhe te Fondi ose edhe le të konsultohen edhe me Rrjet, por e drejtë, po mendoj e drejtë elementare është që secili ta thotë mendimin e vet dhe nëse ka gra që kanë hezituat, unë personalisht, si paneliste, po ndihem shumë keq ose edhe organizatori dhe atëherë, pse e çka kemi bërë ne këtu që ato me u ndikuar për të vepruar më ndryshe.

**Eli Krasniqi:** Po, nuk ka nevojë për të dramatizuar, Nora! Është çështje e individit që dikush nuk ndjehet shumë mirë të flasë në publik, qysh unë e kam pasur atë problem. Jo pse ju si organizatorë ose me ndonjë tjetër takim publik e keni pamundësuar, absolutisht nuk ishte fjala aty. Fjala ke që, nëse është kjo arsyeja, po ashtu ta përfundoj edhe një herë pyetjen, për të mos pasur asnjë hapësirë të keqkuptohemi. E mora shembull veten, që, duke shkuar në shtëpi, nganjëherë më bie ndërmend diçka. Pra, është e mundshme me pas edhe këtë mundësi. Aty, kur thua, mundet edhe në “Partners Kosova” direkt, por të jetë vetëm propozim, po mendoj.

**Shukrije Gashi:** Faleminderit, Eli! Fjalën e ka Gazmiri. Urdhëroni!

**Gazmir Raci:** Veç diçka! Është mirë me u kthye në temë dhe në disa shqetësime që u ngritën këtu, për shembull. E kishte Lola, një pyetje e bëri, si do të bëhet zgjedhja e këtyre komisionarëve, më herët. Dhe, u pa edhe në dokumentar, se ishin disa komisionarë dhe e dimë ne që këta komisionarë janë pjesë e atyre komisioneve që kanë marrë fakte dhe kanë mbledhë dokumentacione. Në bazë të asaj çka kemi mësuar nga rastet e komisioneve tjera, janë disa forma që mblidhen këta komisionarë. Është forma e caktimit, e emërimit dhe forma e zgjedhjes. Për shembull, Komisioni i Argjentinës i ka pasur 10 komisarë të caktuar nga kryetari i shtetit. 6 zgjedhën nga Parlamenti i shtetit – nga radhët e deputetëve. Kurse, anëtarët e Komisionit të Perusë dhe Komisionit në Çil janë emëruar nga kryetarët e këtyre shteteve. Kemi rastin kur në Marok, mbreti i Marokut e ka emëruar Komisionin dhe komisionarët në bazë të propozimit që e ka bërë Komiteti Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut në Marok. Pastaj, kemi rastin e Guatemalës, ku sekretari i përgjithshëm i OKB-ës e ka emëruar një profesor gjerman të së drejtës si kryetar të Komisionit në Guatemalë. E kemi edhe rastin e Afrikës së Jugut ku ata kanë krijuar njëfarë këshilli dhe e kanë hapur një lloj konkursi publik ku secili qytetar, secili intelektual, aktivist, aktor, muzikant i të gjitha shtresave kanë kandiduar për të qenë pjesë e këtyre komisioneve dhe në fund ai këshill, pas intervistave dhe proceseve të verifikimit, ka vendosur se kush mund të jetë anëtar i këtyre komisioneve. Kështu ka ndodhur edhe në Sera Leone, do me thënë ka qenë një panel seleksionues që shteti e ka krijuar dhe pastaj është ardhur deri te një komision më gjithëpërfshirës. E kemi edhe rastin e Timorit Lindor te Komisioni i vërtetës – pranimi dhe pajtimi ku kemi Këshillin për emërime e kanë përbërë përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, të partive politike, prej aktivistëve dhe të gjitha shtresave sepse kanë dëshiruar të jetë më gjithëpërfshirës. Faleminderit!

**Veprorë Shehu:** Po e marr fjalën për herë të fundit për sot. Filmi na ka sqaruar shumë gjëra dhe në mënyrë praktike e kemi parë se si funksionon një komision. Shumë i mirë sepse, në vend që të prezantohen disa faqe të punës së këtij komisioni, me një film 20-minutësh i kuptuam të gjitha. Duke parë filmin, unë veç shënova diçka. E s'postova me vëmendje më tek komisioni se sa tek viktimat, tash. Se për viktimat folëm edhe më herët. Nuk është punë e lehtë me u përball me trauma dhe me u përcjell trauma edhe te anëtarët e Komisionit. Ne kemi mësuar se është traumatizimi sekondar po aq i rëndë sa traumatizimi primar dhe sigurisht se duhet paraparë përkrahje për anëtarët e Komisionit gjatë tërë këtij procesi, sikur që parashihet përkrahje për viktimat. Duhet pasur supervizione, shkarkuese e ku të di unë. Janë ato mënyra profesionale të përkrahjes të personave që merren me dëshmi rrëqethëse të luftës. E kemi pasur përvojën me gratë tona që i marrin në terren dhe që i përkrahin gratë dhe i kam parë në çfarë gjendje janë kthyer në Shoqatë, kur kanë marrë rrëfime shumë rrëqethëse. E dyta. Ajo çka mendoj, nuk duhet me u përmend fillimisht, të paktën gjatë fazës fillestare të punës, është fjala pajtim. E pash edhe në film si reagoi ajo viktimë kur u përmend. Këto komisione le të quhen vetëm komisione të së vërtetës. Automatikisht, në momentin kur integrohet fjala pajtim, do të ketë në start një mosbesim nga ana e viktimave. Tjetra. Anëtarët e Komisionit? Shtrohej pyetja në film, a mos duhet me pas anëtarë të komisionit persona me përvoja të ngjashme me viktimat. E kemi pa prej përvojës sonë se shumë shpesh kanë ndihmuar në ndërtimin e besimit të ndërsjellë nëse vërtet edhe ti ke pësuar humbje gjatë luftës. Ka qenë shumë më lehtë me iu qas viktimës. Dhe, krejt e fundit. Shtrohet pyetja, a është distanca profesionale ajo që mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit? Unë mendoj se duhet të ketë empati dhe e pamë prej anëtarëve të Komisionit që empatia ndikon shumë që të ndërtohet besimi me viktimën dhe me ata që do të japin dëshmi. Sado profesionale me qenë, është shumë vështirë me mbajt distancë kur ke punë me kësi lloj rrëfimi. Kaq kisha për sot. Faleminderit!

**Shukrije Gashi:** Faleminderit! Urdhëroni!

**Abdullah Ferizi:** Unë, për herë të parë po paraqitem sot! Forumi ZFD. Desha vetëm një shpjegim të shkurtër apo një qartësim. Zonja e përmendi terminologjinë dhe është diçka për të cilin kisha pasur qejf me komentuar. U përmend pajtimi dhe pastaj Komisioni për të vërtetën. Nëse shikoni në dokumente, Komisioni i propozuar thirret Komisioni për Zbardhjen e Fakteve, bile edhe fjala e “vërtetë” është evituar si diçka që mundet me qenë subjektive dhe varet prej perceptimit të njerëzve. Vetë emërimi Komisioni për Zbardhjen e Fakteve, tregon edhe qasjen e këtij komisioni ndaj pajtimit, të cilën, unë personalisht, e shoh si diçka individuale që mund të ndodhë por edhe nuk ka nevojë me ndodh. Po mendoj është ajo shumë personale dhe varet prej njerëzve. Po ajo çka ky komision provon me pas si detyrë, është me i zbardhë faktet për të kaluarën në territorin e ish-Jugosllavisë. Dëshira ose në njëfarë mënyre ideja është që më në fund, pas një periudhe disa shekullore, ky rajon i Ballkanit me mund me pas një histori të përbashkët. Për një të ardhme të përbashkët nuk po flasim se është diçka për të cilën këto shtete që secila prej tyre janë të pavarura, mund të merren vesh ose jo se qysh do të vazhdojnë të ardhmen. Mirëpo, çka është me rëndësi, është se e kaluara të zbardhet dhe me i evituar mundësitë për manipulim me të kaluarën dhe ajo, që u përmend disa herë, rehabilitimi i viktimave të kësaj së kaluarës. Veç kaq desha unë. Faleminderit.

**Shukrije Gashi:** Po, urdhëroni Bekim!

**Bekim Blakaj:** Unë prapë, Bekim Blakaj. Do të tentoj të jem sa më i shkurtër. Unë desha në fakt, të lidhem me një brengë të zonjës para filmit. Ju e përmendët, ose dikush e përmendi, më falni – kërkim faljen, që ndoshta para Komisionit, para të gjithave, do të duhej të ishte një kërkim falje prej anës së Serbisë e kështu me radhë.

Gjatë e kemi biseduar këtë çështje dhe sigurisht se kërkim falja është e domosdoshme. Mirëpo, kam frikë se është, sikur që thonë në gjuhën sportive – gabim në hapa. Si qëndrojnë gjërat tani, unë nuk e kam ndonjë shpresë që në një të ardhme të afërm Serbia do të kërkojë falje dhe do të ishte ndoshta një humbje e madhe që me prit ne deri sa të bëhet ajo kërkim falje. Mirëpo, nëse e keni vërejtur, në film, njëra prej komisionarëve të Komisionit, në seancë të Komisionit kërkoi falje në emër të vet dhe në emër të komunitetit të saj, do me thënë të shtresës më të lartë.

Në fakt, Komisioni është një instrument fakt mbledhës ose hulumtues, ishte dashur të jetë i tillë, gjithkund kanë qenë ashtu. Kështu që, kur të nxirren faktet, atëherë megjithatë të gjithë jemi njerëz... U përmend edhe shfaqja publike e dëshmimeve. Domethënë, jo vetëm në sallë por edhe mediat e kanë një rol shumë me rëndësi në atë proces. Dhe, ideja, që e kemi diskutuar një kohë të gjatë nëpër konsultime të ndryshme se mediat ishte dashur të jenë shumë aktive dhe këto dëshmi publike me u përcjell te opinioni i gjerë, sepse vërtet, unë mendoj, meqë edhe kam kontakte të ndryshme, që jo gjithkush i di faktet. Jo gjithkush! Kanë dëgjuar për disa numra, për disa të vrarë, mirëpo ndryshe është kur të dëgjosh drejtpërdrejt prej viktimës çka i ka ndodhur. Prandaj, unë besoj se pas këtyre, pas punës së Komisionit kërkim-falja kishte me qenë e domosdoshme dhe besoj se askush s’kishte me hezitur të thotë – jo, s’dua me kërkuar falje, nëse ballafaqohet me këto fakte. Pra, ndoshta nuk e kemi prekur sot këtë temë, ose rolin e medieve në punën e Komisionit dhe shpresoj se në konsultimet e ardhshme do të diskutohet më shumë për këtë çështje. Më falni se ju mora këtë kohë!

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit, Bekim! A ka edhe ndokush tjetër prej jush që dëshiron? Urdhëroni!

**Shukrije Gashi:** Desha të ndërlidhem te kërkim-falja. Vjen momenti kur është i domosdoshëm edhe kërkimi i faljes mirëpo në përgjithësi çdo viktimë është e interesuar me i zbardhë rastet e tyre, me i dit faktet kush është përgjegjës dhe me ballafaquar atë person dhe me qit para

drejtësisë. Një – më fal! Nuk çohet fare në atë aspektin emocional ajo as që vjen në shprehje, sepse ajo nuk t'i kthen personat më të dashur. Do me thënë, humbja është e pa kompensueshme. Mirëpo, është shumë me rëndësi që vjen momenti, po them prapë, që edhe kjo kërkim-falje e ka edhe atë anën e saj të dobishme të them në thonjëza prapë, sepse vjen momenti që këta njerëz që janë gjallë kanë nevojë për përkrahjen nëse jo prej shtetit atëherë prej atyre personave që janë përgjegjës e për këtë është shumë e rëndësishme që çdo komision, apo të paktën anëtarët e këtij komisioni ta marrin këtë punë me seriozitetin e domosdoshëm, pra si një diçka që është shumë serioze e të dinë me iu qas rasteve të këtilla. Pra, të ju tregojnë atyre se ata janë të interesuar me i zbardhë këto fakte e jo vetëm se kinse po e kryejnë një punë e në këtë mënyrë me i bërë viktimat me u largua prej tyre. Faleminderit!

**Valdete Idrizi:** Faleminderit! Unë dua të bëj një sqarim, që është shumë i rëndësishëm, shumë esencial dhe që lidhet shumë me suksesin, mos suksesin dhe punën e KOMRES. Duhet bërë një dallim të qartë në mes punës së komisionarit dhe misionarëve ose përkrahësve që punojnë në terren të një komisioni të tillë. Deri tek sqarimi i rëndësisë së krejt çështjes, për me ardhur deri at dhe për me pas informacione sa më shumë dhe për me ia shtua peshën e rëndësinë kësaj pune, varet shumë prej aktivistëve ose misionarëve që punojnë në terren. Do me thënë, në këtë rast misionarët që punojnë në terren është shoqëria civile.

Prandaj, varet shumë prej nesh se sa ne do të angazhohemi dhe sa ia dimë rëndësinë një procesi të tillë. Ndërsa, puna e komisionarit ka natyrë tjetër. Do me thënë ato elemente që i përmenda unë, i përmendën edhe më herët edhe Gazmiri e të gjithë ne, disa prej nesh, përzgjedhja e tyre do të varet nga modeli qysh do të merremi vesh, do të thotë qeveritë në mes veti nën mbikëqyrjen e rreptë, këtë e them pa rezervë, në kuptim pozitiv të shoqërisë civile. Kurse për shtjellimin, sqarimin, shohitjen e punës së koalicionit për KOMRA kjo mbetet thjeshtë çështje e punës sonë në terren, e interesimit tonë si shoqëri civile, e interesimit të organizatave veç e veç.

Nëse ne sot, prej këtu, dalim dhe nuk marrim me vete si detyrë dhe si përgjegjësi se kjo është diçka shumë e rëndësishme, një çështje shumë e rëndësishme dhe se duhet qenë shumë azhurë, atëherë natyrisht se do të dështojmë kësaj radhe edhe një herë për përcjelljen e informatës tek te tjerët.

Edhe sikur se është dëshmuar disa herë në praktikë, që e përmenda edhe më herët, me mbledhjen e Rrjetit të grave, unë kam pritur, të paktën unë, me sa e di praktikën e punës së Rrjetit të grave nuk ndodhë shpesh që ato mos ta mbajnë fjalën. Për arsye se secila mungesë e një gruaje këtu, është pjesë e mozaikut, e dështimit. Prandaj, unë e di, dhe jam e sigurt se të gjitha ju sa jeni këtu, në mbledhjen e ardhshme do ta bëjmë të madhe këtë punë – mospjesëmarrjen e tyre. Dhe natyrisht se nuk do të ketë....

**(Ndërhyrje)**

E kanë konfirmuar të gjitha. E kanë konfirmuar dhe s'kanë ardhur. Prandaj, po them se kjo ka rëndësi se sa ne e marrim seriozisht këtë çështje. Kaq kisha! Nëse ka dikush tjetër diçka, le të urdhërojë. Urdhëroni Valdete!

**Valdete Idrizi:** Veç desha të them që mos të jemi në një qasje përjashtuese. Nuk është mirë se njerëzit nuk po i përgjigjen ftesave dhe u përmend më herët edhe për përfaqësuesit e institucioneve, mirëpo desha vetëm të tregoj se është proces dhe jo ndoshta që qëllimisht e tregova se është nesër takimi konkretisht i nivelit lokal në rajon të Pejës dhe shumë shpejtë do të jetë edhe në Vushtrri, shumë shpejt do të ketë edhe konsultime tjera. Prandaj është shumë me rëndësi kjo, dhe nëpër këto dokumente janë edhe e mail adresat që me të vërtetë që ajo grua dhe të gjitha këto pas veti, do të thotë ekziston bashkëpunimi edhe me ato që nuk janë

këtu e jo me pas qasje, të them, përjashtuese dhe të thuhet se s'kanë ardhur dhe nuk bën me ardhur e me i kritikuar. Fakt është se duhet gishtin kah vetja gjithherë me qit para se të qitet te dikush tjetër. Por është shumë me rëndësi që të kihet një qasje më gjithëpërfshirëse do të thotë për ne së pari si shoqëri civile. U dëgjua këtu për shumë pyetje, po edhe filmin e kam parë më herët dhe sa i përket kësaj se kush do të jetë komisionar dhe sa objektivë do të jenë ata, sa profesionistë. Unë nuk e besoj se ne si shoqëri civile, ndoshta këtë punë shumë të madhe që po e bëjmë të gjithë ne, ndoshta nuk do të lejojmë sikur thuhet në gjuhë popullorçe të shkohet në lloç dhe ne do të jemi ata që do të dizajnojmë, të them, mandatin dhe ne do të jemi ata që do t'i dizajnojmë edhe kriteret në bazë të të cilave do të zgjedhën komisionarët dhe njëkohësisht me pa edhe rrugën tjetër, që u përmend edhe më parë, njëfarë mbikëqyrjeje, njëfarë vlerësimi i punës së tyre.

Prandaj, mendoj se është shumë me rëndësi që të jemi edhe më të hapur dhe të kemi një qasje pak më gjithëpërfshirëse dhe vërtet ai njeri që do me pas informatë, do me dit ku ndodhen konsultimet, mund ta gjejë. I keni edhe këto në dokumenta këtu mail-adresat po edhe mundeni me gjet prej njëra-tjetrës.

Mua më vjen shumë keq që ndoshta s'munda të flas, por nuk jam mirë me shëndet dhe po më duhet nganjëherë të dal e të flas. Faleminderit!

**Shukrije Gashi:** Po, urdhëroni!

**Sevdije Bunjaku:** Kosovës dhe njëherit edhe anëtare dhe përfaqësuese e Koalicionit për paqe “Gratë në të zeza” dhe Rrjeti i grupit të grave të Kosovës. Dëgjova shumë dhe po e përsëndes këtë takim dhe me të vërtetë është diçka që duhet të punohet në të ardhmen për zbardhjen e të gjitha krimeve ndaj nesh. Edhe Lola e ceku më herët, në vitin 2006 ka qenë Koalicioni për paqe, që është kurorëzuar me dy konferenca në Strugë dhe në njërën konferencë, do të thotë në Konferencën e parë e cila është mbajtur në vitin 2006 unë kam qenë vetë aty pjesëmarrëse dhe është kërkuar falje publike prej “Grave në të zeza”. Mirëpo, sot shoh diçka aty, sikur që tha Shuki se “Rrjeti i grupeve të grave” nuk janë këtu. Këtu e kemi edhe drejtoreshën e Bordit. Ne jemi anëtare të Rrjetit, të devotshme dhe më vjen keq pse nuk e shoh në asnjë organizatë, e cila është këtu, nga organizatat serbe me të cilat ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë dhe ato organizata, që do të thotë se unë punoj mjaft me to dhe do të thotë jam edhe një themeluese e një rrjeti jo formal të grave serbe në Kosovë dhe nuk e shoh asnjërin këtu, sidomos Snezhanën e cila ...

**(Ndërhyrje)**

... E di se e kanë konfirmuar, por ato më së pari nuk e njohin Rrjetin, do të thotë “Gratë në të zeza” dhe mua më vjen shumë keq, vërtet, që sot nuk e shoh asnjërin nga ato. Prandaj, për Në Rrjetin e grupit të grave të Kosovës kemi përfaqësues mjaft dhe besoj se të gjitha ne, si organizata jo qeveritare jemi anëtare të Rrjetit të grupit të grave të Kosovës. ...

**Shukrije Gashi:** Një sqarim, zonjusha Kunac. Izvolite!

**Suzana Kunac:** Disi jemi kah përfundimi i konsultimeve të sotme dhe kam dashur të theksoj se janë këto situata normale, janë fillime të konsultimeve në Kroaci, që ne nuk kemi arritur që përmes komunikimit me përfaqësuesit e Rrjetit të grave të Kroacisë, edhe pse ata vërtet kanë punuar dhe bashkëpunuar me viktimat e luftës por nuk kanë zënë hapin në Koalicionin për themelimin e Komisionit për përcaktimin e argumenteve në ish-Jugosllavi që në të vërtetë ka qenë diçka për tu habitur.

Procesi ka pasur një ecje të ngadalshme. Tek ne, në fillim, kanë marrë pjesë shumë më pak femra. Unë e konsideroj këtë takim të suksesshëm dhe unë mendoj që në hapin vijues do të bëheni pjesë e një familjeje të madhe të 150 e sa organizatave dhe mbi 200 pjesëmarrësve. Ne

jemi duke u rritur e shtuar, të them kështu dhe duhet punë dhe sensibilizim më i madh dhe kjo është diçka e njohur. Është me rëndësi të dëgjohet sot zëri juaj rreth asaj për çfarë jemi tubuar këtu dhe kjo, do të thojë, me këtë edhe ta përfundoj, janë këto konsultime tuaja dhe do të isha vërtet e lumtur sikur t'i lajmërohem edhe përfaqësuesve në Bosnje, në Beograd dhe atyre të Kroacisë që ne sot këtu kemi dal me atë se vërtet jemi të përgjegjshme dhe se duam e dëshirojmë që dhuna të përcaktohet si krim kundër njerëzimit dhe të përfshihet në mandatin e Komisionit. Nuk e di se a është kjo ashtu, dikush e ka shumë më lehtë të flas në opinion dhe duhet të vendosim dhe të lëmë të hapura të gjitha mundësitë dhe kanalet e komunikimit.

Kemi thënë dhe tentoj që unë tani ta bëj një përmbledhje për të gjithë atë që kam dëgjuar këtu. Duhet të sigurohet mbështetja e anëtarëve të Komisionit. Natyrisht, edhe mbështetja e anëtarëve por edhe një kujdes i veçantë ndaj trajtimit të viktimave – keqtrajtimit seksual.

Pra, pajtohem që ky Komision është rajonal, nuk dëgjova asnjë zë që është kundër kësaj dhe tani mund të vazhdojmë tutje. Dhe që është ajo që ju sot këtu që na keni dëgjuar, pra çka mendoni dhe a keni komente lidhur me këtë që biseduam dhe çka mendoni se duhet përfshirë në procesverbal. Unë, fillova e para për këtë.

**Sakibe Doli:** Unë sot kam marrë një mesazh që nga sot do të jem misionare e këtij Komisioni. Pse e them këtë? Në radhë të parë për ta shëruar vetveten sepse dhjetë vjet kanë kaluar dhe nëse mblidhemi me një grup, pa marrë parasysh çfarë niveli është, ne kemi me shkuar te lufta. Janë trauma të mëdha, të cilat nuk janë shëruar, janë zbeh por jo shëruar.

Unë e pash rolin e misionarëve të cilët kishin dalë fshat me fshat, rrugë me rrugë sepse vetëm kështu bëhet puna. Jam shumë e angazhuar, do të thotë, me viktima të luftës të cilat kërkojnë përkushtim të madh. Punoj në shkollë, kam një vajzë të vogël dhe megjithatë unë kam gjetur kohë për të ardhur këtu.

Dashuria për njerëzit shfaqet në shumë mënyra. Unë sot këtë e kam shfaqur këtu. Do me thënë jam e gatshme për me punuar.

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit shumë, zonja Sakibe që përkundër krejt sentimentit, dhembjes, angazhimit gjeni fuqi dhe në këto momente të ofroni përkrahjen tënde dhe të jepni kontributin për diçka që është pjesë e të gjithë neve në të ardhmen. Faleminderit! Të uroj suksese! Nëse nuk ka pyetje tjera, a mundemi ta përmbledhim në pika të shkurtra. Mendoj se zonja Sakibe përmbledhi këtë shumë mirë dhe këtu s'ka çka të thuhet tjetër. Në parim ju pajtoheni që të formohet një komision. Sugjerimet kanë qenë shumë konstruktive sidomos nga ana e djathtë më shumë se sa nga ju, nga ana e majtë. Do me thënë janë përmendur edhe një herë që dhunimet të hyjnë patjetër si shkelje në mandatin e Komisionit, si shkelje e të drejtave kundër njerëzimit – si krim. Pastaj, mënyrat e shkeljes së të drejtave të njeriut të përcaktohen, a do të jenë tortura, a do të jenë masakrime. Këto janë disa mënyra të cilat pastaj edhe do të shtjellohen. Ne kemi edhe sugjerime tjera dhe do të merren parasysh, do të thotë kualifikimi i luftës - a ka qenë luftë apo gjenocid, apo ka qenë spastrim etnik dhe këto terme duhet të kristalizohen para se të futen në mandat. Kërkim-falja duhet të jetë patjetër, do të thotë ka qenë një si sugjerim shumë konstruktiv propozimi i Elit dhe i grave nga rajonet tjera, të cilat disa që kanë hezituat me thënë mendimin e tyre, gjë që merret parasysh dhe ato gra e vajza të cilat kanë pasur ide dhe nuk i kanë shfaqur këtu i parashirojnë ato përmes Rrjetit ose përmes “Partners Kosovës” dhe Fondit për të Drejtën Humanitare. Ma merr mendja se u sqarua puna se ky komision a do të jetë komision i pajtimit apo i së vërtetës, gjë që shumë në mënyrë afirmative e thanë edhe kolegët, por edhe Shuki dhe Valdetja që janë në trupin koordinues dhe e dinë shumë mirë që kjo veç është definuar dhe ky do të jetë Komision i së vërtetës dhe jo i pajtimit dhe ky është fillimi dhe fundi.



U përmend edhe çështja e viktimizimit dhe empatisë. Do të thotë kush do të jenë komisionarët. Është pikë ose element shumë me rëndësi personi i cili ka pasur familjarë të zhdukur ose ka përjetuar dhunën në njëfarë mënyre ai e ndien empati ndaj tjetrit me të cilin do të punojë në terren, mirëpo në njëfarë mënyre kjo komponentë e viktimizimit dhe vuajtjes, sepse vuajtja është komponentë shumë me rëndësi se nëse ti e ke përjetuar vetë ti do të ndihesh më ndryshe ose do të jesh më i ndjeshëm ndaj vuajtjes së tjetrit pa marrë parasysh dallimin etnik, racor apo gjinor. Terminologjinë po ashtu duhet ta kemi parasysh. Shuki e përmendi se shoqëria civile do të ketë rol jo vetëm mbikëqyrës në dhënien e rekomandimeve, por do të ketë ndoshta edhe rol shumë aktiv dhe në mënyrë shumë të rreptë do t'i verifikojë po qe se vihet deri te formimi i Komisionit dhe në mënyrë shumë të rreptë do të verifikohen sjelljet e qeverisë se çfarë hapa do të marrë ajo konform interesave tona dhe konform vetë formimit të Komisionit rajonal KOMRA. Të adresohet gjithashtu mungesa e organizatave joqeveritare dhe kryesisht e minoriteteve dhe atyre serbe. Nuk e di këtu a ka minoritarë tjerë... Okej. Dhe, edhe një herë falënderoj zonjën Sakibe që ishte shumë e hapur për propozimin dhe ne mundemi me të konsideruar si misionare të këtij Komisioni dhe unë uroj që të kemi sukses, po edhe konsultimet me grupet tjera të shoqërisë civile ta kenë të njëjtën dinamikë dhe të jenë konstruktive sikur ky sot. Me këtë, mendoj se edhe po e mbyllim këtë punëtori ose konsultim. Nëse kanë diçka organizatorët apo Besarta më tepër, le të urdhërojnë.

**Besarta Vasija:** Faleminderit, Nora! Unë jam Besarta Vasija, prej Fondit për të Drejtën Humanitare. Unë vetëm desha të ju informoj të gjithëve dhe në njëfarë mënyre edhe t'i përgjigjem Elit se çka pas këtyre konsultimeve. Të gjitha rekomandimet, propozimet dhe komentet do t'u dërgohen të gjithëve në e-mail-adresat pas përfundimit të raportit tonë, të cilin e bëjmë për konsultime. Po qe se keni ndonjë pyetje, apo ndonjë koment tjetër, në e-mail-adresat tuaja do të mund ta gjeni deklaratën për bashkëngjitje. Faleminderit edhe një herë shumë që keni gjetur kohën për të ardhur këtu. Më vjen mirë që sot ju keni qenë shumë konstruktivë dhe ne dëshirojmë që ju të jeni vazhdimisht kështu aktivë dhe ne do të ju informojmë edhe për konsultimet tjera të ardhshme dhe do të jeni të mirëseardhur gjithmonë.

**Shukrije Gashi:** Vetëm edhe një shtesë, Valdetja, pastaj Veprorja.

**Valdete Idrizi:** Do të provoj mos ta zgjas. E kam vetëm një informatë, sa i përket organizatave jo qeveritare të komunitetit serb. Ju informoj se në procesin e konsultimeve kanë marrë pjesë edhe organizatat dhe shoqatat familjare dhe njëkohësisht është edhe një organizatë që quhet Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në veri të Mitrovicës e cila organizatë do të organizojë në nivelin lokal – do të thotë organizata e komunitetit serb, por njëkohësisht kanë shprehur gatishmëri që të jenë pjesë e procesit.

**(Ndërhyrje)**

Jo, nuk kanë qenë të ftuar se nuk janë organizata të grave. Mirëpo, ata e kanë paraparë edhe datën se kur do ta organizojnë këtë në Mitrovicë. Po ashtu desha vetëm të them se kur kanë qenë edhe pjesë e Forumit edhe në Prishtinë por edhe në Podgoricë, jo në Podgoricë por në Beqiq. Me këtë po dua të them se janë shumë të dedikuar rreth këtij procesi, mirëpo e kam se atë empatinë e kanë ndarë bashkë. Dhe është gjithsesi procesi i dhembshëm por kur flasim për viktimë flasim për të gjithë.

Më preku shumë, do të thotë, fjalja e zonjës Sakibe dhe dëshiroj vetëm shkurt të ju tregoj, se në shkurt të vitit të kaluar, kur kam qenë pjesë e Forumit të tretë rajonal në Beograd që është mbajtur, isha në toalet kur një grua, ishte edhe ajo familjare e komunitetit serb dhe më tha, a je edhe ti prej Kosove, thash po. Kë e ke të zhdukur apo të vvarë? Më ka prekë shumë dhe i thash, jo domosdoshmërisht duhet me pas dikë të familjes së ngushtë të zhdukur apo të vvarë që të

merrem me këtë çështje. Kjo është gjithsesi obligim i të gjithë neve dhe ne po i themi vetit që jemi aktivë. Në shoqëri civile po themi se kemi pas veti edhe disa qytetarë, disa përfitues të aktiviteteve në të cilat jemi të kyçur e atëherë gjithsesi duhet ta luajë rolin e vet. Faleminderit shumë!

**Veprorë Shehu:** Unë vetëm desha që në rezymenë që e bëri Nora diçka të them. E kam përshtypjen se dy çështje janë harruar dhe kështu të sigurohem para se të shkoj prej këtu. Posaçërisht, meqë kanë dalë prej meje ato dy rekomandime. Duhet gjithsesi të shënohet që për Komisionin nevojitet përkrahje për shmangien e traumatizmit sekondar ...

**(Ndërhyrje)**

Po, e ka thënë por nuk e di a e përmendi këtë. Dhe e treta, ma kujtoj Valdetja. Është kjo një çështje shumë e rëndësishme që të marrin pjesë edhe OJQ-ët që merren me të drejtat e njeriut, do të thotë mos të merren vetëm me të drejtat e grave, por të jenë gjithsesi edhe pjesë e këtij procesi organizatat joqeveritare që merren edhe me burra dhe jo vetëm me gratë.

Dhe, edhe diçka, një përgjigje shumë të rëndësishme e kemi lënë anash dhe këtë e kam shënuar para filmit, por harrova me potencuar. Kur bëhet fjalë për mbledhjen e dëshmimeve, dëgjimin publik. Unë personalisht mendoj se nuk bëhet fjalë ballafaqimi me kryerësit e veprave. Viktimat nuk duhet të ballafaqohen me kryerësit e veprave. E dimë këtë prej përvojës së Hagës, e dimë prej përvojës tonë dhe mendoj që është me rëndësi që kjo të futet në procesverbal. Kaq unë.

**Besarta Vasija.** Mirë! Atëherë, nëse ju mendoni se viktimat nuk duhet me u ballafaquar me kryerësit e krimeve, a ka mundësi me na dhënë më shumë argumente, pse. Dhe tjetra, do të thotë si do të mund ne t'i kënaqim viktimat meqë ne e dimë se në shumë raste viktimat kanë nevojë me dit se kush e ka bërë atë dhe pse e ka bërë atë.

**Veprorë Shehu:** Nuk bëhet fjalë për identifikim. Normalisht se duhet me i identifikuar, por jo me qenë pjesë e komisionit ose në atë hapësirë ku janë viktimat të jenë edhe ata që kanë bërë krime. Kjo është shumë e rëndë për dëshmitarët dhe është shumë e rëndë për viktimat. Ajo gruaja që ne e kemi çua në Hagë dhe ka dëshmuar gjatë procesit të Millosheviqit, e ka ndie veten shumë keq, ka qenë shumë e irrituar pse iu ka lejuar atij me bë pyetje edhe pse seanca ka qenë e mbyllur. Sepse për raste të dhunë seksuale dhe krime seksuale seancat janë të mbyllura në Gjykatën e Hagës.

**Nora Ahmetaj:** Faleminderit Veprorë! Unë konsideroj se kjo do të merret parasysh gjithsesi por kjo edhe ka dallim nga rasti në rast. Dikush ndihet mirë të dëshmojë pikërisht para dhunuesit, dikush nuk dëshiron. Do të thotë, kjo do të përdoret nga rasti në rast, varësisht si aplikohet.

**(Ndërhyrje)**

**Shukrije Gashi:** Sa i përket, për shembull fjala vjen rastet e të dhunuarave, ai është komplet e kuptueshme. Gjithsesi e kuptueshme që ato nuk dëshirojnë të ballafaqohen me dhunuesin dhe nuk dëshirojnë të bëjnë dëshmi publike në prani të qytetarëve. Do të thotë është kjo krejt çështje individuale se si do t'i qasemi.

Mua, tash më mbetet vetëm të ju falënderoj shumë të gjithëve juve që keni marrë pjesë në këtë këshillim i cili është i rëndësishëm së veçantë. E çmoj shumë angazhimin e të gjitha juve. E falënderoj shumë panelin e prezantuesve. Falënderoj shumë angazhimin e përkthyesve, të logjistikës, organizatorët dhe e çmoj shumë kohën tuaj që ia keni përkushtuar një procesi kaq të rëndësishëm. Falënderoj zonjën Sakibe edhe një herë dhe të gjithë ju tjerat. Unë kam besim të plotë që Rrjeti i Grave të Kosovës dhe të gjitha ju tjerat që keni marrë pjesë në këtë këshillim që do ta përcillni rëndësinë e këshillimeve të tilla tek të gjithë ata që bashkëpunoni me ta, tek

familjet tuaja, për arsye se të gjithë ne kemi familje dhe pothuaj të gjitha familjet në Kosovë janë të prekura nga ky proces dhe besoj se në të ardhmen e afërt do të jemi të gjithë më azhur në angazhimin tonë në këto këshillime.

Unë nuk kam për të shtuar diçka tjetër. Tash jeni të ftuar që të drekoni dhe besoj se në të ardhmen e afërt do të shihemi sërish. Faleminderit shumë!

Dhe, për çështjen e pagesës së shpenzimeve të rrugës, mund të drejtoheni tek Mentori.